

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “ HASAN PRISHTINA ”
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË

Departamenti : AGROEKONOMI

Programi: Ekonomia e Bujqësisë dhe Ushqimit



PUNIM I DIPLOMËS MASTER

**EFEKTI EKONOMIK DHE FINANCIAR I ZËVENDËSIMIT TË MIELLIT TË
IMPORTUAR ME PRODHIM VENDOR**

Mentori :

Prof. Dr. Mujë Gjonbalaj

Kandidati :

Veton Veliu

Prishtinë, Shtator 2021

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “ HASAN PRISHTINA ”

FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË

Departamenti: AGROEKONOMI

Programi: Ekonomia e Bujqësisë dhe Ushqimit



PUNIM I DIPLOMËS MASTER

**EFEKTI EKONOMIK DHE FINANCIAR I ZËVENDËSIMIT TË MIELLIT TË
IMPORTUAR ME PRODHIM VENDOR**

Mentori :

Prof. Dr. Mujë Gjonbalaj

Kandidati :

Veton Veliu

Prishtinë, Shtator 2021



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

FAKULTETI _____

Nr. Prot.: _____

Datë: ___/___/___

DEKLARATË E STUDENTIT PËR PUNË ORIGJINALE

Me anë të kësaj deklarate, unë Veton Veliu, me përgjegjësi, deklaroj se ky punim nuk është prezantuar për vlerësim apo botuar më parë, pjesërisht apo në tërësi, pranë këtij apo ndonjë institucioni tjetër. Më tej, deklaroj se:

- a) punimi i paraqitur këtu është origjinal dhe është punuar në tërësi nga unë*
- b) punimi nuk është marrë nga studentë të tjerë apo nga punime të tjera në Universitetin e Prishtinës 'Hasan Prishtina' ose nga ndonjë universitet tjetër;
- c) punimi nuk është kopje e ndonjë punimi të marrë në internet apo në bibliotekë;
- ç) punimi nuk përmban modifikim të dhënash, duke i paraqitur ato si kontribut origjinal;
- d) punimi i respekton të gjitha kërkesat për të drejtat e autorit, duke i saktësuar dhe cituar të gjitha kontributet nga burime të tjera.

Ky punim i diplomës vlen për nivelin e studimeve _____ dhe e mban titullin:

_____.

Dëshmoj se jam i vetëdijshëm që vërtetimi ndryshe i atyre që u thanë më sipër do të rezultojë me tërheqjen e titullit të fituar bazuar në këtë punim.

Prishtinë, më ___/___/___

Studenti/ja - nënshkrimi

MIRËNJOHJE DHE FALENDERIME

Një falenderim i veçantë i takon mentorit tim, Prof. Dr. Mujë Gjonbalaj për ndihmën, këshillat dhe angazhimin e tij gjatë gjithë kohës së punimit tim.

Po ashtu falënderoj familjen time, për mbështetjen dhe përkrahjen e tyre. Përkrahja e tyre gjatë gjithë kohës, ishte motivim për mua, që të arrij këtë sukses.

I falënderoj të gjithë ata që më mbështetën dhe më inkurajuan, gjatë gjithë kohës së studimeve dhe punimit të këtij punimi të diplomës.

Pasqyra e pëmbajtjes

Mirënjohje dhe falënderime	5
ABSTRAKT	6
ABSTRAKT	8
Lista e figurave.....	9
Lista e tabelave.....	10
1.1 Sfondi i studimit dhe arsyeshmëria e temës	11
1.2. Objektivat.....	14
1.3 Pyetjet dhe hipotezat hulumtuese.....	14
1.3.1 Hipotezat	14
1.3.2 Pyetjet hulumtuese.....	14
1.4 Rezultatet e pritshme.....	15
1.5 Kufizimet e punimit.....	15
1.6. Struktura e punimit.....	16
1.7. Arsyeshmëria e temës	17
1.8. Rezultatet e pritura.....	17
1.8.1 Metodatat e përdorura	17
Kapitulli 2 RISHIKIMI MBI LITERATURËN E FUSHËS	18
2. Vështrim i përgjithshëm mbi ekonominë dhe tregtinë e Kosovës	18
2.1 Bilanci tregtar i Kosovës	18
2.2. Vështrim i përgjithshëm mbi bilancin tregtar të Kosovës (Qarkullimi i mallrave në tregtinë e jashtme)	19
2.3. Mjedisi i përgjithshëm ekonomik	22
2.3.1 Bruto Produkti Vendor (BPV).....	22
2.4. Eksporti dhe importi i produkteve bujqësore	25
2.4.1. Eksporti dhe importi i drithërave në Kosovë	25
2.5 Importi i grurit në Kosovë	27
2.5.1 Importi i grurit në Kosovë gjatë viteve 2014-2020.....	27
2.6 Kultivimi i drithërave në Kosovë	29
2.6.1 Kultivimi i grurit në Kosovë	29

2.6.2 Prodhimtaria e grurit në Kosovë.....	31
2.6.3 Rendimenti i grurit	32
2.6.4 Çmimi për njësi të grurit të importuar	33
2.6.5 Çmimet e fermës të prodhimeve bujqësore (grurit)	33
2.6.6 Krahasimi i çmimeve vendore me çmimet në vendet e regjionit dhe BE-së.....	34
2.7 Prodhimi bujqësor dhe përdorimi i tij.....	37
2.7.1 Përdorimi i tokës bujqësore	37
2.7.2 Kultivimi i tokës bujqësore në Kosovë.....	37
2.7.3 Madhësia e fermave në Kosovë.....	38
2.8 Konsumi i miellit të grurit dhe grurit në Kosovë.....	39
2.8.1 Përlogaritja e konsumit vjetor të miellit të grurit dhe grurit në Kosovë	39
2.9 Importi i miellit.....	41
2.9.1 Importi i miellit në Kosovë.....	41
2.10 Rishikimi i literaturës.....	42
2.10.1 Historia e teorisë së zëvendësimit të importit.....	43
2.10.2 Raúl Prebisch dhe çështja për zëvendësimin e importit.....	44
2.10.3. Ekonomistë të tjerë të zhvillimit mbi zëvendësimin e importit.....	46
KAPITULLI 3: METODOLOGJIA DHE METODAT E HULUMTIMIT	49
3.1 Metodologjia e aplikuar	49
KAPITULLI 4: REZULTATET DHE DISKUTIME.....	50
4.1 Marrëdhënia ndërmjet çmimit dhe cilësisë	50
4.2 Cilësia përcakton çmimin.....	51
4.2.1 Përcaktimi (formulimi) i çmimit në miell dhe grur	51
4.2.2 Faktorët përcaktues të çmimit të grurit janë:	51
4.2.3 Faktorët përcaktues të çmimit të miellit janë:	52
4.3 Përcaktimi (formulimi) i çmimit shitës të miellit në tregun Kosovar.....	52
4.3.1 Përcaktimi (formulimi) i çmimit shitës te mielli Tip 400.....	53
4.3.2 Përcaktimi (formulimi) i çmimit shitës te mielli T-/Special (premium)	54
4.3.3 Përcaktimi (formulimi) i çmimit shitës te mielli T-500.....	56

Vërtetimi i hipotezave	58
Hipoteza 1.....	58
4.4 Konkluzionet mbi mardhënien ndërmjet cilësisë dhe çmimit.....	58
4.5 Shpenzimet (kostoja) e përfitimit të miellit në Kosovë	59
4.5.1 Shpenzimet (kostoja) e përfitimit të miellit Tip 500	59
4.5.2 Shpenzimet (kostoja) e përfitimit të miellit Tip 400	60
4.5.3 Shpenzimet (kostoja) e përfitimit të miellit Tip special (Premium)	62
Hipoteza 2.....	63
4.6 Politika e zëvendësimit të importit	63
4.6.1 Zëvendësimi i importit të miellit në Kosovë	63
4.6.2 Instrumentet e Politikës Tregtare	64
4.7 Zëvendësimi i Importit	65
4.7.1 Identifikimi i përparësive krahasuese në Kosovë.....	67
Hipoteza 3.....	69
4.8 Efekti Financiar dhe ekonomik i zëvendësimit të miellit dhe grurit nga importi me prodhim vendor	69
4.8.1 Efekti financiar dhe ekonomik i zëvendësimit të miellit nga importi me prodhim vendor	69
4.8.2 Efekti financiar dhe ekonomik i zëvendësimit të grurit nga importi me prodhim vendor.....	71
4.8.3 Efekti financiar dhe ekonomik i zëvendësimit të grurit nga import me prodhim vendor	72
4.9 Procesimi i Grurit: Kultivimi deri në Korrje	74
4.9.1 Marzha bruto dhe të ardhurat neto për ha	75
Rekomandimet	78
Konkluzionet	79
REFERENCAT/BIBLIOGRAFIA	83
Shtojcat.....	87

ABSTRAKT

Hulumtimi paraqet një raport të detajuar për sektorin e miellit dhe grurit në Kosovë. Në mënyrë specifike, punimi ofron analizë mbi zëvendësimin e importit të produkteve të grurit, përkatësisht miellit. Fillimisht, është analizuar struktura e sipërfaqes së kultivuar me grurë, rendimenti i grurit, si dhe importi dhe eksporti i tij.

Më pas, shtjellohet Bruto Produkti Vendor me çmime akutale, Bruto Produkti Vendor për kokë banori, çmimet e grurit nga importi, çmimet e grurit në Kosovë dhe në rajon.

Pjesa tjetër e hulumtimit, shtjellon konsumin e miellit në Kosovë, importin e miellit, dhe shpenzimet vjetore për importin e miellit. Gjatë shtjellimit të produktit të miellit, do të analizohet kostoja dhe fitimi nga shitja e miellit të prodhuar në vend.

Sipas raportit të (Agjencisë së Statistikave të Kosovës, 2020), importi i mallrave në Kosovë në vitin 2020 ishte në vlerë 3.3 miliardë €, përkundër eksportit, i cili ishte vetëm 475 milionë €.

Sipas të dhënave nga (MPBZHR 2020), në vitin 2019 vlera e drithërave të eksportuara nga Kosova ishte 340,000 €, që në krahasim me vitin 2018 kishte një rënie për 46,000 € ose për - 12.%. Ndërsa, importi paraqitet me zvoglim në shkallë prej 2.6% krahasuar me vitin 2018, dhe me bilanc negativ prej 34.1 mil. €.

Hulumtimi ka një rëndësi të veçantë, pasi që gjetjet hedhin dritë mbi konkurrueshmërinë e miellrave vendor me ato të importuara. Sa për ilustrim, ekziston një trend negativ i zëvendësimit të importit të produkteve të miellit gjatë viteve 2014-2020, Sipas raportit të Doganës së Kosovës, vlerësohet se sasia mesatare e grurit të importuar ishte rreth 107 milionë kg. grurë në vit, ndërsa importi i miellit në të njëjtën periudhë ishte rreth 25 milionë kg.

Edhe përkundër stimulimeve të ofruara nga Qeveria, që nga paslufta, Kosova asnjëherë nuk ka arritur të përmbush nevojat vjetore të konsumit me miell nga prodhimi vendor.

Më zvogëlimin e importit të miellit dhe grurit, do të rritet prodhimi i miellit dhe kultivimi i grurit. Në këtë rast do të rritej përfitimi për prodhuesit vendor. Po ashtu, do të rritej numri i sipërfaqeve të kultivuara me grurë, e rrjedhimisht do të rritej edhe numri i të punësuarve. Dhe siguria për konsumin e miellit do të ishte më e lartë.

Në bazë të hulumtimit, të gjeturat tregojnë nevojën për rritje të përkrahjes të gjithë sektorit të bujqësisë, në veçanti të sektorit të drithërave. Duke ndryshuar politikat e caktuara, rritjen e subvencioneve për bujqësi, rritjen e kontrollit në doganë, etj. Po ashtu, qeveria duhet t'ia mundësojë ose lehtësojë, që bujqit të furnizohen me farë cilësore, me qëllim të rritjes së cilësisë së grurit dhe rritjen e rendimentit.

Fjalët kyçe: konsumi i miellit, importi i miellit, kultivimi i grurit, rëndësia e grurit, zëvendësimi i importit të grurit dhe miellit, siguria e ushqimit.

ABSTRACT

The research presents a detailed report on the flour and wheat sector in Kosovo. Specifically, the paper provides analysis to replace the import of wheat products, namely flour. First, was analyzed the structure of the area cultivated with wheat, grain yield, wheat import and its export.

Then, is discussed about Gross Domestic Product at current prices, Gross Domestic Product per capita, wheat prices of import, wheat prices in Kosovo and the region.

The rest of the research deals with flour consumption in Kosovo, flour imports, and annual costs for flour imports. During the processing of flour, will be analyzed the cost and profit from the sale of locally produced flour.

According to the report of the (Kosovo Agency of Statistics, 2020), the import of goods in Kosovo in 2020 was worth € 3.3 billion, despite the export which was only € 475 million.

According to data from (MAFRD 2020), in 2019 the value of cereals exported from Kosovo was 340,000. €, which compared to 2018 had a decrease of € 46,000 or -12.%. While imports are presented with a decrease of 2.6% compared to 2018 and with a negative balance of 34.1 mil. €.

The research is of particular importance, as the findings shed light on the competitiveness of local flours with imported ones. As an illustration, there is a negative trend of substitution of imports of flour products during the years 2014-2020, it is estimated that the average amount of imported wheat is about 107 million kg of grain per year, while the import of flour in the same period was about 25 million kg.

Despite the incentives provided by the Government, since the post-war period, Kosovo has never been able to fulfill the annual needs of consumption of flour from local production.

With the reduction of the import of flour and wheat, the production of flour and the cultivation of wheat will increase, as the profit for the local producers would increase, the number of employees would increase, the number of areas cultivated with wheat, as well as the security for flour consumption will be higher.

According to the research, all the signs show the need to increase the support of the entire agricultural sector, especially the cereals sector, by changing certain policies, increasing subsidies, control of seed wheat, increase control in customs, as well as the government should supply farmers with better quality and higher yields, in order to increase grain quality and increase yields.

Keywords: flour consumption, flour import, wheat cultivation, importance of wheat, replacement of wheat and flour import, food security.

Lista e figurave

Figura 1: Eksporti dhe importi i mallrave 2014-2020.....	28
Figura 2: Bruto Produkti vendor me çmime aktuale gjatë viteve 2016-2020.....	30
Figura 3: Bruto Produkti vendor për kokë banori me çmime aktuale gjatë viteve 2016-2020.....	31
Figura 4: Vlera e Eksportit dhe importit të drithërave gjatë viteve 2014-2019.....	33
Figura 5: Importi i grurit në Kosovë në sasi dhe në vlerë gjatë viteve 2014-2019.....	35
Figura 6: Kultivimi i grurit në Kosovë gjatë viteve 2014-2019.....	37
Figura 7:Çmimet e grurit në Kosovë dhe disa vende të BE-së në vitin 2019, €/kg.....	42
Figura 8: Modeli i suksesshëm konceptual i zëvendësimit të importit në ekonominë moderne globale.....	55
Figura 9: Fitimi neto në euro nga shitja e 1 ton miell.....	69
Figura 10: Përfitimet nga zëvendësimi i importi të grurit me prodhim vendor në shkallë nga 10% deri 50%.....	80

Lista e tabelave

Tabela 1: Eksporti dhe importi i mallrave 2014-2020.....	26
Tabela 2: Bruto Produkti vendor me çmime aktuale gjatë viteve 2016-2020.....	29
Tabela 3: Bruto Produkti vendor për kokë banori me çmime aktuale gjatë viteve 2016-2020.....	29
Tabela 4: Vlera e Eksportit dhe importit të drithërave gjatë viteve 2014-2019.....	30
Tabela 5: Importi i grurit në Kosovë në sasi dhe në vlerë gjatë viteve 2014-2019.....	33
Tabela 6: Kultivimi i grurit në Kosovë gjatë viteve 2014-2019.....	34
Tabela 7: Prodhimtaria e grurit në Kosovë gjatë viteve 2014-2019.....	35
Tabela 8: Rendimenti i grurit në Kosovë t/ha.....	36
Tabela 9: Çmimet e importit të prodhimeve bujqësore (grurit), €/kg.....	37
Tabela 10: Çmimet mesatare vjetore të prodhimeve bujqësore në fermë (grurit), €/kg	37
Tabela 11: Çmimet e grurit në Kosovë dhe disa vende të BE-së në vitin 2019, €/kg.....	38
Tabela 12: Importi i miellit në Kosovë 2014-2020.....	43
Tabela 13: Kostoja e përpunimit të grurit vendor, për përfitimin e miellit T-500.....	54
Tabela 14: Shpenzimet (kostoja) për përfitimin e miellit Tip 400.....	55
Tabela 15: Shpenzimet (kostoja) për përfitimin e miellit Tip Special - (Premium).....	56
Tabela 16: Efektet e zëvendësimit të miellit ngs importi me prodhim vendor.....	64
Tabela 17: Efekti ekonomik i zëvendësimit të grurit nga importi me prodhim vendor.....	67
Tabela 18: Kalkulimi i kostos se prodhimit të grurit në Kosovë.....	68

Pasqyra e shkurtesave

Ha – Hektarë, njësi matëse e sipërfaqës

Kg- Kilogramë, njësi matëse e peshës

MPBZHR Ministria e Pylltarisë, Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

ASK- Agjencia e Statistikave të Kosovës

BPV- Bruto Produkti Vendor

CEFTA Marrëveshja për tregti të lirë me vendet e Evropës Qendore

DAESB Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore

BE Bashkimi Evropian

ISO Organizata Ndërkombëtare për Standardizim

UNCTAD- United Nations Conference on Trade and Development

Miell – Produkt i fituar pas bluarjes dhe përpunimit të kokrrave të grurit

Miell tip 400– miell i fituar nga bluarja e grurit standard, me kufirin maksimal të hirit 0.450

Miell tip 500– miell i fituar nga bluarja e grurit standard, me kufirin maksimal të hirit 0.550

Miell tip Special– miell i fituar nga bluarja e grurit durum, me kufirin maksimal të hirit 0.450

KAPITULLI 1

HYRJE

1.1 Sfondi i studimit dhe arsyeshmëria e temës

Sot, si burim më i rëndësishëm i ushqimit në botë vazhdojnë të mbeten drithërat, duke kontribuar deri në 50 përqind të kalorive, esenciale për njeriun. Kontributi i tyre në marrjen e energjisë ndryshon dukshëm, midis vendeve në zhvillim dhe atyre industriale.

Në vendet në zhvillim, të tilla si në Afrikë dhe një pjesë të Azisë, drithërat mund të kontribuojnë deri në 70 përqind, të marrjes së energjisë. Ndërsa, në vendet industriale, për shembull, Mbretëria e Bashkuar, drithërat sigurojnë afërsisht 30 përqind të marrjes së energjisë dhe 50 përqind të karbohidrateve të disponueshme.

Sipas parashikimeve të ekspertëve të ushqimit, deri në vitin 2050, pritet që përqindja e drithërave në kalori, që përdoren si ushqim për njeriun, të vazhdon të ulet ngadalë nga 54 përqind në vitin 2001, në 49 përqind në vitin 2030 dhe 46 përqind në vitin 2050.

Gjatë viteve të fundit, ekonomia e Kosovës po përballet më një deficit të madh tregtar, me një disbalancë të madhe ndërmjet importit dhe eksportit të mallrave.

Përparimi në konsolidimin dhe mbrojtjen e tokës bujqësore, nga Qeveria është i pamjaftueshëm. Po ashtu, mbështetja dhe rritja e subvencioneve, granteve dhe formave të tjera të ndihmës, e bërë deri më tani nga Qeveria, nuk ka dhënë rezultate të duhura.

Zëvendësimi i miellit nga importi do të kishte disa efekte pozitive, si në aspektin ekonomik dhe financiar, po ashtu edhe në aspektin e sigurisë së ushqimit.

Gruri është drithi më i rëndësishëm i bukës, dhe kultura me pjesëmarrje më të madhe të mbjelljes nga grupi cereal. Viteve të fundit, ka një trend negativ sa i përket sipërfaqeve të mbjellura. Por, edhe rendimentet të arritura nuk janë të kënaqshme. Sipërfaqet e mbjelljes së grurit pak ndryshojnë nga viti në vit, si rezultat i faktorëve të ndryshëm, duke përfshirë kushtet e motit në sezonin e mbjelljes, pritjet e planifikuara të ndërmarrjes, etj.

Në Republikën e Kosovës, gruri është një nga dy produktet kryesore bimore, sipas pjesës në zonën e mbjelljes dhe sasisë së prodhimit. Në strukturën e mbjelljes së drithërave, gruri zë rreth 80 mijë hektarë, me prodhim mesatar rreth 340 mijë ton në vit gjatë dekadës së fundit^{*2}. Për shkak të deficitit me grurë dhe miell vendor, Kosova akoma vazhdon të mbetet një importuese e madhe e grurit dhe miellit në Ballkanin Perëndimor¹.

Sipas të dhënave nga MPBZHR, në periudhën prej vitit 2014 deri në vitin 2019, importi i grurit dhe produkteve nga gruri ishte pothuajse konstant, me ndryshime të vogla ndërmjet viteve. Tregjet kryesore të importit për grurë dhe produkte të grurit janë: Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Austria, dhe Hungaria².

Në Kosovë, pasi që fermat janë të fragmentuara dhe përdorimi i burimeve është shumë pak i efektshëm, janë faktorë kryesor që struktura ekzistuese e prodhimit ka një kosto të lartë në prodhim.

Për shkak të kësaj, fermat nuk janë në gjendje të arrijnë një përdorim efikas të tokës. Niveli i ulët i rendimenteve të grurit kushtëzohet nga një pjesë e madhe e prodhimit, për nevojat e tyre vetanake.

Çmimet e larta të inputeve, makineritë e vjetra dhe rënia e investimeve, e bëjnë të vështirë për të rritur produktivitetin dhe prodhueshmërinë. Fermat e mëdha kanë më shumë gjasa të zgjedhin zbatimin e teknologjive të reja dhe ato zakonisht kanë rendimente më të larta. Produktiviteti i ulët në prodhim ka një ndikim negativ në konkurrencën e çmimeve dhe sjell prodhuesin mesatar bujqësor në një pozitë të vështirë në treg.

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës, (ASK), 2019, (parë për herë të fundit 26.01.2021)

² Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) – regjistrimi i fermave bujqësore në Kosovë (12.13.15.16.17) (parë për herë të fundit 26.01.2021)

Sidoqoftë, këto ferma veprojnë kryesisht brenda kufijve të riprodhimit të thjeshtë, me elemente të theksuara të prodhimit natyror dhe të thjeshtë të mallrave ³. Madhësia e fermës është thelbësore për efikasitetin e operacioneve në bujqësi, kështu që, mund të konkludohet se me madhësi kaq të pafavorshme, fermat vështirë se mund të jenë konkurruese në treg dhe të ndikojnë në rritjen e konkurrencës.

Mungesa e sipërfaqeve të kultivuara me grurë, veçanërisht grurë cilësor, rritja e importit të grurit cilësor nga Serbia, Bosna dhe Hercegovina, Austria dhe Hungaria, rritja e importit të miellit cilësor dhe të sigurt, ka ndikuar në rritjen e kostos së prodhimit të miellit. Po ashtu, ka ndikuar edhe në rritjen e çmimit të miellit.

Mundësia e kultivimit të grurit cilësor ekziston, vetëm duhet siguruar fara e grurit kualitativ, rritja e subvencioneve dhe ndihmat e tjera nga qeveria. Me plotësimin e këtyre parakushteve do të rritej sipërfaqja e kultivuar dhe rendimentet më të larta.

Problemi tjetër me rëndësi është importi i miellit, i cili shitet si miell, e në fakt parametrat e vërtetë nuk janë ashtu siç përshruhen në ambalazh.

Dhe problem tjetër, i cili është një ndër problemet thuajse më të shprehura, është vetëdija e konsumatorit. Sepse, konsumatori vendas ka një besim të luhatshëm në lidhje me cilësinë e miellrave vendor. Duke besuar në konsumin e miellit të importuar, me pretekst se mielli nga importi është më i mirë për arsye të origjinës së prodhimit, nënkupton besueshmëri dhe kualitet më të lartë.

Ndërsa, ky fakt nuk qëndron aspak, sepse mielli vendor është kualitativ, çmimi është më i volitshëm dhe siguria gjatë prodhimit është më e lartë.

³ Nikolic, Olivera; Jelic Miodrag; Jovanovic, Ljubinko , VARIABILITY OF SERBIAN WINTER WHEAT GENOTYPES AND THEIR EVALUATION IN TERMS OF SUSTAINABLE AGRICULTURE 2004

https://www.researchgate.net/publication/262685011_VARIABILITY_OF_SERBIAN_WINTER_WHEAT_GENOTYPES_AND_THEIR_EVALUATION_IN_TERMS_OF_SUSTAINABLE_AGRICULTURE (parë për herë të fundit 25.01.2021).

1.2. Objektivat

Objektivi kryesor

- Efekti ekonomik dhe financiar i zëvendësimit të miellit nga importi me prodhim vendor.

Objektivat specifike

- Identifikimi i faktorëve që ndikojnë në rritjen e kultivimit të grurit vendor.
- Përcaktimi i sipërfaqes dhe rendimentit të grurit të kultivuar.
- Identifikimi i aftësisë konkurruese me vendet e rajonit.
- Përcaktimi i përfitimit ekonomik nga kultivimi i grurit dhe prodhimi i miellit.
- Përcaktimi i raportit ndërmjet çmimit dhe cilësisë së miellit.

1.3 Pyetjet dhe hipotezat hulumtuese

1.3.1 Hipotezat

- 1. Çmimi i miellit ndikon në cilësinë e tij/ cilësia ndikon në çmimin e miellit.
- 2. Politika e zëvendësimit të miellit në Kosovë.
- 3. Efekti ekonomik dhe financiar i zëvendësimit të miellit nga importi me prodhim vendor.

1.3.2 Pyetjet hulumtuese

1. Cili do të ishte përfitimi financiar i fermerëve, me rritjen e sipërfaqeve të kultivuara me grurë në vend?
2. Cili do të ishte përfitimi i prodhuesve të miellit (mullinjëve) me rritjen e prodhimit të miellit?
3. Cilat do të ishin përfitimet e kompanive tjera, apo pjesëmarrësve të tjerë, pas rritjes së kultivimit të grurit vendor dhe rritjes së prodhimit të miellit?

1.4 Rezultatet e pritshme

Nga ky hulumtim është pritur të nxirren rezultate që na pasqyrojnë gjendjen agroekonomike të vendit, bilancin tregtar të drithërave, sipërfaqet dhe rendimentin e grurit të kultivuar.

Po ashtu, nga ky hulumtim pritet të pasqyrohet leverdeshmëria nga kultivimi i grurit, përfitimet nga prodhimi i miellit, përcaktimin e faktorëve që ndikojnë në cilësinë e miellit, dhe përfitimin ekonomik, me zëvendësimin potencial të miellit nga importi me prodhim vendor.

1.5 Kufizimet e punimit

Punimi është i bazuar kryesisht nga të dhëna primare, të fituara nga intervista me pronarët e mullinjëve të miellit, drejtorët e prodhimit, drejtorët financiar si dhe menaxherët e cilësisë të industrisë së prodhimit të miellit të grurit.

Të dhënat sekondare janë të dhëna të marra nga literatura e huaj, literatura vendore, studimet e ndryshme nga autorë të huaj, të dhëna të publikuara nga Dogana e Kosovës, MPBZHR, Raporti i Gjellbër i Kosovës etj.

Të dhënat e paraqitura rreth teorive ekonomike mbi zëvendësimin e importit, janë të dhëna të bëra në periudha të ndryshme kohore. Disa publikime të bëra kohëve të fundit, e disa publikime të bëra shumë vite më parë, kryesisht nga autorë të huaj.

Pjesa tjetër e të dhënave, që konsistojnë për kultivimin dhe rendimentin e grurit, janë të dhëna të viteve të fundit.

Të dhënat e paraqitura në hulumtim, i takojnë kryesisht periudhës nga viti 2014 gjerë në vitin 2020, dhe këto të dhëna, kryesisht, janë literatura apo publikime të autorëve vendas.

Mungesa e kultivimit të kultivarëve cilësorë të grurit ka ndikuar në rritjen e sasisë së importit të grurit dhe miellit nga vendet tjera.

Hulumtimi është i përqendruar në tërë rajonin e Kosovës, për arsye se kultivimi i grurit është i shpërndarë pothuajse në tërë territorin e Kosovës.

Pra, edhe në aspektin e kultivimit të grurit, dhe në aspektin e prodhimit të miellit, hulumtimi kufizohet në aspektin e përfshirjes së të dhënave në tërë territorin e Kosovës.

Po ashtu, edhe fabrikat për prodhimin e miellit janë të shpërndara në disa prej qyteteve të Kosovës.

1.6. Struktura e punimit

Të dhënat e paraqitura në hulumtim, janë të dhëna të fituara nga intervistat, si dhe të dhëna të marra kryesisht nga autorë të ndryshëm, të huaj ose vendor të cilët janë marr me studimin mbi ekonominë e zëvendësimit të importit,

Pjesa tjetër e të dhënave do të vë në dukje përshkrimin e gjendjes ekonomike në Kosovë, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara nga Dogana e Kosovës, MPBZHR, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Raporti i Gjellbër i Kosovës dhe të tjerë.

Hulumtimi është i organizuar në pesë kapituj kryesor dhe në secilin kapitull do të përshkruhen aspektet mbi përmbajtjen e hulumtimit.

Kapitulli i parë: përmban hyrjen, në të cilën përfshihen sfondi i studimit, objektivat kryesore dhe ato specifike të punimit, pyetjet dhe hipotezat e punimit, kufizimi i punimit dhe struktura e punimit.

Kapitulli i dytë: përshkruan gjendjen e bujqësisë në Kosovë, përkatësisht gjendjen e kultivimit dhe rendimentit të grurit ndër vite. Po ashtu, në këtë kapitull, përshkruhet sipërfaqja e kultivuar me grurë, importi dhe eksporti i drithërave, Bruto Produkti Vendor. Më pas, në këtë kapitull elaborohet mbi kuptimin e teorisë së zëvendësimit të importit, periudhën e ngritjes dhe rënies së kësaj teorie në botë.

Kapitulli i tretë: Përmban metodologjinë dhe metodat mbi të cilat është i punar ky hulumtim.

Kapitulli i katërt: paraqet rezultatet dhe diskutimet mbi hulumtimin e bërë. Në këtë kapitull do të elaborohet mbi çështjen e raportit të përcaktimit të çmimit të miellit, raportin ndërmjet çmimit dhe cilësisë etj.

Kapitulli i pestë: përmban rekomandimet dhe konkluzionet. Në këtë kapitull do të analizohet efekti se si do të ndikonte zvogëlimi i importit të miellrave në aspektin financiar dhe ekonomik

tek prodhuesit vendor. Pra, cili do të ishte efekti ekonomik dhe financiar nëse do të zevendësohej mielli i importuar me miell vendor, si dhe gruri i importuar me grurë vendor.

1.7 Arsyeshmëria e temës

Hulumtimi do të jetë me rëndësi për arsye se do të hedhim dritë mbi gjendjen e prodhimit bujqësor në vend, në veçanti kultivimit të grurit. Po ashtu do të kemi një pasqyrë reale të përshkrimit mbi leverdinë ekonomike dhe financiare të fermerëve apo prodhuesve të miellit mbi koston, fitimin e kultivimit të grurit apo prodhimit të miellit në Kosovë.

Përmbajtja e temës do të jetë me karakter përshkrues të faktorëve ekonomik dhe financiar të cilët ndikojnë direkt në zhvillimin e sektorit të prodhimit të miellit në Kosovë.

1.8 Rezultatet e pritura

Kushtet e favorshme klimatike, toka e mirë, fuqia punëtore janë parakushtet kryesore, të cilat mund të ndikojnë në rritjen e kultivimit të grurit. Po ashtu, edhe në rritjen e vetëdijes së konsumatorit në konsumin e miellit vendor. Sepse, me rritjen e prodhimit vendor të kultivimit të grurit si dhe me rritjen e prodhimtarisë së miellit në vend do të kemi këto profite:

- Të ardhurat të cilat shpenzohen për import, do të mbesin në vend.
- Do të rritet numri i fabrikave të cilat do të prodhojnë miell.
- Me rritjen e numrit të fabrikave, do të rritet numri i punëtorëve dhe do të zvogëlohet papunësia.

Prodhuesit nëpër furra do të kenë rendiment më të lartë, cilësi më të lartë dhe produkte më kualitative me çmim më të ulët se tani.

Pas një kohe të shkurtër, ekziston mundësia e eksportit të miellit vendor në vendet e rajonit, duke krijuar mundësi për një përfitim edhe më të lartë.

1.8.1 Metodatat e përdorura

- Metoda historike
- Metoda deskriptive- përshkruese

- Metoda statistikore
- Metoda komparative - krahasuese

Kapitulli 2 RISHIKIMI MBI LITERATURËN E FUSHËS

2. Vështim i përgjithshëm mbi ekonominë dhe tregtinë e Kosovës

2.1 Bilanci tregtar i Kosovës

Deficiti tregtar vazhdon të mbetet ende një shqetësim i vazhdueshëm për ekonominë e Kosovës. Mbështetja e madhe në importe dhe një nivel i kufizuar i eksporteve kanë rezultuar në një deficit tregtar të vazhdueshëm, gjë që kërkon masat e politikës strukturore për përmirësim. Për më tepër, meqenëse deficiti tregtar financohet kryesisht nga remitancat, dhe në rast se ato fillojnë të zvogëlohen, ka një nevojë të menjëhershme për të hartuar një strategji, që do të çojë në një reduktim të deficitit tregtar.

Spektori i bujqësisë mund të shërbejë si një burim i zhvillimit në Kosovë, veçanërisht nëse është zhvilluar sektori i pemëve, perimeve po ashtu dhe drithërave.

Në mënyrë që kjo të arrihet, atëherë duhet të ofrohen rekomandime nga profesionistët e fushës. Më pas duhet të kemi më shumë përfshirje në hulumtime për sektorin e bujqësisë, sasi më të madhe të buxhetit qeveritar, të alokuar për këtë sektor, përmirësimin e ligjit të kontratave dhe zbatimin e tyre. Përmirësimi i standardeve dhe i paketimit, dhe krijimi i shërbimeve këshilluese dhe trajnimeve⁴

2.2. Vështrim i përgjithshëm mbi bilancin tregtar të Kosovës (Qarkullimi i mallrave në tregtinë e jashtme)

Që nga viti 1999, bilanci tregtar negativ ka qenë shqetësimi kryesor ekonomik për Kosovën. Çdo vit, importet e mallrave tejkalojnë kryesisht eksportet e saj, gjë që e çon vendin në një deficit të madh tregtar, duke u ulur kështu konkurrenca e Kosovës në tregjet rajonale dhe

⁴ Myderizi, Arzana. Kosovo's comparative advantages: The agriculture sector,(august 15, 2013).

ndërkombëtare⁵. Bilanci negativ vazhdon akoma të mbetet i tillë, edhe viteve të fundit, ku hendeku ndërmjet eksportit dhe importit është shumë i madh. Raporti ndërmjet eksportit dhe importit në Kosovë është 1:8.

Në vijim do të paraqesim tabelën e cila paraqet bilancin ekonomik, më konkretisht paraqet eksportin dhe importin e Kosovës në Euro nga viti 2014 deri në vitin 2020.

Tabela 1. Eksporti dhe importi i mallrave 2014-2020

Periudha	Eksporti €	Importi €	Bilanci tregtar €	Përqindja e mbulimit
1	2	3	4=2-3	5=2/3*100%
2014	324,543,000	2,538,337,000	-2,213,794,000	12.8
2015	325,294,000	2,634,693,000	-2,309,399,000,	12.3
2016	309,627,000	2,789,491,000	-2,479,864,000	11.1
2017	378,010,000	3,047,018,000	-2,669,008,000	12.4
2018	367,500,000	3,347,007,000	-2,979,507,000,	11.0
2019	360,400,000	3,255,800,000	-2,895,400,000	11.2
2020	474,960,000	3,296,918,000	-2,281,958,000	14.4

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës/ statistikat e tregtise se jashtme

Eksporti i mallrave në muajin dhjetor 2020 kishte vlerën 46.7 milionë €, ndërsa importi 355.9 milionë €, që është një rritje prej 73.6% për eksport dhe 6.2% për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019.

Në bazë të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 36.6% të eksporteve e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 14.6% e përbëjnë artikujt e ndryshëm të prodhuar; 11.2% e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 9.3% e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani;

⁵ Myderizi, Arzana. Kosovo's comparative advantages: The agriculture sectore, (august 15, 2013).

5.1% e përbëjnë produktet minerale; 4.8% e përbëjnë produktet bimore; 4.7% e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike, etj.

Ndërsa, sipas të dhënave të grupeve kryesore për import: 15.4% e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 13.5% e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 10.7% e përbëjnë produktet minerale; 10.4% e përbëjnë mjetet e transportit; 10.1% e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 7.5% e përbëjnë produktet e industrisë kimike; 5.6% e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre, etj.

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 12.9 milionë €, ose rreth 27.7% e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 15.6%. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE janë: Gjermania (8.9%), Italia (6.1%), Holanda (2.2%), etj.

Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 165.2 milionë €, ose 46.4% e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 1.8%. Importet me pjesëmarrje më të lartë ishin nga: Gjermania (14.0%), Italia (5.6%), Greqia (3.8%), Polonia (3.3%), etj.

Në muajin dhjetor 2020, eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 23.0 milionë €, ose 49.4% të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 89.6%. Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s ishin: Shqipëria (30.7%), Maqedonia e Veriut (9.5%), Serbia (4.7%), dhe Mali i Zi (3.2%).

Ndërsa, importet nga vendet e CEFTA-s, në muajin dhjetor 2020, arritën në 69.2 milionë €, ose 19.4% të importeve të përgjithshme, me një rritje prej 67.6%. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Serbia (6.5%), Shqipëria (5.7%), dhe Maqedonia e Veriut (5.3%).

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 10.6 milionë €, ose 22.9%. Si partner më të rëndësishëm nga këto vende për eksport vlen të përmenden: Zvicra (8.5%) dhe SHBA (8.1%).

Ndërsa, importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 121.5 milionë €, ose 34.1%. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Turqia (11.7%) dhe Kina (10.0%).

Në vitin 2020 vlera e përgjithshme e eksportit të mallrave nga Kosova me vendet e tjera të Evropës dhe botës arrin rreth 475,000 €, ndërsa importi i mallrave ishte rreth 3.2 miliardë €. Bilanci tregtar në vitin 2020 ishte -2.8 miliardë €, me përqindjen e mbulimit vetëm 14.4%.

Në vitin 2020 eskporti arriti vlerën më të lartë, duke shënuar rreth 92 mijë € më shumë, se sa në krahasim me vitin 2019 apo (23%), dhe 96 mijë € më shumë se sa në vitin 2018 ose (+29%).

Ndërsa, importi, vlerën më të lartë e arriti në vitin 2019, me vlerë të përgjithshme të importit e cila ishte afër 3.5 miliardë €, ose 200 milionë më shumë në krahasim me vitin 2020 ose (+6%) më shumë.⁶




Figura 1: Eksporti dhe importi i mallrave 2014-2020

⁶ <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/statistikat-e-tregtise-se-jashtme-stj-dhjetor-2020> dhe kalkulime të autorit (parë për herë të fundit 25.01.2021)

2.3. Mjedisi i përgjithshëm ekonomik

2.3.1 Bruto Produkti Vendor (BPV)

BPV është treguesi më i rëndësishëm ekonomik në Sistemin e Llogarive Kombëtare, që paraqet performancën e ekonomisë së një shteti për një periudhë kohore. Bazuar në rezultatet e anketës së BPV-së shihet se, BPV me çmime aktuale në vitin 2019 ishte 7,103.8 mil.€. Rritja reale në vitin 2019, në krahasim me vitin 2018 ishte 4.9% ndërsa, BPV për kokë banori për vitin 2019 ishte 3,986 €.

Rritje reale për vitin 2019 kishte në këto aktivitete ekonomike: aktivitetet financiare dhe të sigurimit 12.1%, administrimi publik dhe i mbrojtjes, sigurimi i detyrueshëm social 9.2%, bujqësia, gjuetia, pylltaria dhe peshkimi 8.0%, furnizimi me energji elektrike, me gaz 6.5%, transporti dhe magazinimi 6.5%, shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale 6.4%, hotelet dhe restorantet 6.4%.

Rritje kishte edhe industria përpunuese 5.3%, tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave 4.3%, ndërtimtaria 3.5%, industria nxjerrëse 3.2%, aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike 3.1%, edukimi 3.0%, furnizimi me ujë 2.6%, aktivitetet administrative dhe mbështetëse 2.5%, si dhe afarizmi me pasuri të patundshme 1.1%. Ndërkaq, rënie në aktivitetet art, zbavitje dhe rekreacion kishte për 38.8%.⁷

Tabela 2. Bruto Produkti vendor me çmime aktuale gjatë viteve 2016-2020

Periudha	Vlera në €
2016	6,070,113
2017	6,413,861
2018	6,725,913
2019	7,103,759

⁷ <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/statistikat-e-tregtise-se-jashtme-sj-dhjetor-2020> dhe kalkulime të autorit.(parë për herë të fundit 25.01.2021)

2020	6,850,800
-------------	------------------

Burimi: Raporti i Gjellbër i Kosovës 2020, Bruto Produkti Vendor me çmime aktuale 2016-2020 dhe kalkulime të autorit (parë për herë të fundit 26.01.2021)

Sipas të dhënave nga Raporti i Gjellbër i Kosovës 2020, Bruto Produkti Vendor i Kosovës për vitin 2020 me çmime aktuale ishte 6,850,800 €, që në krahasim me vitin 2019 kishtë një rënie në vlerë 252,000 € ose (-3.55%), mirëpo në krahasim me vitin 2018 u shënuar një ngritje e lehtë në vlerë prej 125,000 € ose (+1.8%).⁸




Figura 2: Bruto Produkti Vendor me çmime aktuale gjatë viteve 2016-2020

Tabela 3. Bruto Produkti Vendor për kokë banori me çmime aktuale gjatë viteve 2016-2020

Periudha	Vlera në €
2016	3,386
2017	3,566
2018	3,746
2019	3,986

⁸ Raporti i Gjellbër i Kosovës (2020),

https://www.mbpzhrks.net/repository/docs/Raporti_i_Gjelber_202003022021.pdf (parë për herë të fundit 18.01.2021)

Burimi: Raporti i Gjelbër i Kosovës, Bruto Produkti Vendor, 2016-2020 dhe kalkulime të autorit

Gjithnjë sipas (Raportit të Gjelbër të Kosovës), ashtu sikur Bruto Produkti Vendor i përgjithshëm, ngjashëm edhe Bruto Produkti Vendor për kokë banori, në vitin 2020 ishte për 336 € më i ulët në krahasim me vitin 2019, ose (-9.2%) gjithashtu, edhe në vlerë prej 96 € më i ulët së sa në vitin 2018 ose (-2.6%)

Sipas të dhënave nga tabela, mund të konkludohet se, Bruto Produkti Vendor për kokë banori, vlerën më të lartë e arriti në vitin 2019, në vlerë prej 3,986 €, ndërsa vlerën më të ulët e arriti në vitin 2016, me vlerë 3,386 €.

Ky ndryshim tregon për një trend pozitiv të rritjes së BPV për kokë banori, me një rritje prej 264 € në vitin 2020 në krahasim me vitin 2016 ose (+7%).




Figura 3: Bruto Produkti Vendor për kokë banori me çmime aktuale gjatë viteve 2016-2020

2.4. Eksporti dhe importi i produkteve bujqësore

2.4.1. Eksporti dhe importi i drithërave në Kosovë

Tabela 4. Vlera e eksportit dhe importit të drithërave gjatë viteve 2014-2019

Periudha	Eksporti €	Importi €	Bilanci €
2014	420,000	31,218,000	-30,798,000
2015	724,000	34,157,000	-33,433,000
2016	335,000	36,327,000	-35,992,000
2017	262,000	31,690,000	-31,428,000
2018	386,000	36,434,000	-36,048,000
2019	340,000	35,450,000	-35,110,000

Burimi: DAESB – MPBZHR; Eksporti dhe importi i drithërave 2014-2019 dhe kalkulime të autorit.

Në vitin 2019 vlera e eksportit të produkteve bujqësore të ishte 340,000 € (MPBZHR), duke shënuar kështu vlerën më të lartë të eksportit që nga viti 2015, vit në të cilin, u shënuua vlera më e lartë e eksportit të produkteve bujqësore, në vlerë prej 724,000 €.

Përparimi në konsolidimin dhe mbrojtjen e tokës bujqësore, i bërë deri më tani është i pamjaftueshëm.

Mund të theksohet se gjatë periudhës ndërmjet viteve 2014-2019 ekzistonte një diferencë e lartë në bilancin midis eksportit dhe importit të drithërave në Kosovë. Gjatë asaj periudhe, bilanci tregtar ndërmjet eksportit dhe importit ishte gjithmonë negativ.

Vlera më ulët e eksportit të drithërave ishte në vitin 2017, në vlerë të përgjithshme prej 262,000 €, ndërsa në krahasim me vitin 2016, eksporti i drithërave ishte për 73,000 € më i ulët dhe 124,000 € më i ulët në krahasim me vitin 2018.

Vlera më e lartë e eksportit të drithërave ishte në vitin 2015, me vlerë të përgjithshme të drithërave të eksportuara prej 724,000 €.

Sa i përket aspektit të importit të drithërave, vlera e importit qëndroi pothuajse në vlerë konstante secilin vit, ku vlera mesatare e importit të drithërave ishte rreth 33 milionë € ne vit.

Vlera më e ulët e importit të drithërave u shënua në vitin 2014 me një vlerë prej 30.7 milionë €, vlerë cila shënoi rritje në vitet në vazhdim dhe në vitin 2015 vlera e importit arriti në 33.4 milionë €, e përcjellur me rreth 36 milionë € në vitin 2016 dhe prej vitit 2016 vlera e importit mbeti pothuajse e pandryshuar deri në vitin 2019.

Vlen të theksohet se vlera mesatare vjetore e importit të drithërave në periudhën 2014-2019 ishte 33.54 milionë € në vit. Ndërsa, vlera mesatare e eksportit të drithërave nga Kosova ishte në vlerë prej 425,400 € në vit.

Në bazë të vlerësimit të ndryshimit ndërmjet importit dhe eksportit të drithërave në Kosovë, mund të themi se vlera mesatare e parasë së shpenzuar nga Kosova për drithëra është 33 milionë € çdo vit. Përqindja mesatare e mbulimit ndërmjet eksportit dhe importit të drithërave në Kosovë sillet nga 1.2% deri 1.6%.




Figura 4: Vlera e eksportit dhe importit të drithërave gjatë viteve 2014-2019

2.5 Importi i grurit në Kosovë

2.5.1 Importi i grurit në Kosovë gjatë viteve 2014-2020

Që nga periudha e pasluftës, pra pas vitit 1999 e tutje, prodhimi vendor në vend asnjëherë nuk ka arritur të përmbushë nevojat vjetore të popullsisë për furnizim me grurë.

Prandaj, pjesa tjetër e kërkesës për grurë u realizua përmes importit të tij.

Në bazë të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2020 importi i grurit në vitin 2014 ishte në vlerë 16.617 mil. €, i përcjellur me rritje të vazhdueshme në dy vitet e ardhshme deri në vitin 2017, vit në të cilin vlera e importit shënoi shifër pothuajse të njëjtë sikurse ajo në vitin 2014, pra 16.5 mil.€.

Trendi pozitiv i rritjes së importit të grurit në vend vazhdoi të mbetej edhe në vitin 2018, vit në të cilin vlera e importit të grurit ishte rreth 20.4 mil. €, pasuar në vitin 2019 ku vlera e importit të grurit arriti në 24.1 mil.€ apo (+45%) më shumë në krahasim me vitin 2014 apo (+33.5%) më shumë se në vitin 2015.

Importi më i lartë i grurit u arritë në vitin 2016 (127,123 ton), ndërsa sasia më e ulët u arritë në vitin 2014 (89.151 ton).

Në periudhën nga viti 2014 deri në vitin 2019, në Kosovë u importua grurë, në sasi mesatare rreth 107.8 mijë ton në vit.⁹

Tabela 5. Importi i grurit në Kosovë në sasi dhe në vlerë gjatë viteve 2014-2019

Viti	Importi i grurit në sasi (ton)	Importi i grurit në vlerë (€)
2014	89,151	16,617,000
2015	98,063	18,068,000
2016	127,123	19,501,000
2017	97,208	16,447,000

⁹ [https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/statistikat-e-tregtise-se-jashtme-stj-dhjetor-2020-dhe-kalkulime-te-autorit-\(pare-për-herë-të-fundit-me-25.01.2021\)](https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/statistikat-e-tregtise-se-jashtme-stj-dhjetor-2020-dhe-kalkulime-te-autorit-(pare-për-herë-të-fundit-me-25.01.2021))

2018	114,054	20,404,000
2019	120,489	24,125,000

Burimi; Ask <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/te-pergjithshme/vjetaret-statistikor-dhe-kalkulime-te-autorit>




Figura 5: Importi i grurit në Kosovë në sasi dhe në vlerë gjatë viteve 2014-2019

2.6. Kultivimi i drithërave në Kosovë

2.6.1. Kultivimi i grurit në Kosovë

Gjatë vitit 2019 në Kosovë, drithëra për kokërr janë kultivuar 124,19 ha, që përbëjnë 65.9% të tokës së përgjithshme të punueshme. Të dhënat nga tabela tregojnë se gruri dhe misri janë kulturat më të rëndësishme në Kosovë sa i përket sipërfaqes së kultivuar dhe prodhimit.

Përqindjen më të madhe të tokës së kultivuar me drithëra e përbëjnë: gruri 64.5%, misri 31.8%, ndërsa pjesa tjetër prej 3.6% është e kultivuar me tërshërë, elb, thekër dhe drithëra tjera.

Në vitin 2019 kishte zvogëlim të sipërfaqes së mbjellur në krahasim me vitin 2018 ku sipërfaqja e mbjellur me grurë pati rënie për 1%.

Në tabelën në vijim, është paraqitur sipërfaqja e kultivuar me grurë, prodhimtaria e përgjithshme e grurit si dhe rendimenti i grurit për ha në periudhën e viteve 2014-2019.

Tabela 6. Kultivimi i grurit në Kosovë gjatë viteve 2014-2019

Viti	Sipërfaqja e kultivuar në (ha)
2014	42,280
2015	89,942
2016	89,122
2017	80,518
2018	81,123
2019	80,00

Burimi: Vjetarët Statistikor 1989, 1993 dhe 1997, Drejtoritë komunale dhe Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore-ASK., kalkulimi i autorit (parë për herë të fundit 15.01.2021)

Sipërfaqja më e madhe e kultivuar me grurë ishte në vitin 2015, me sipërfaqe të përgjithshme rreth 90 mijë ha. Sipërfaqe e përafërt të kultivuar me grurë rreth 89,2 mijë ha ishte në vitin 2016, si dhe me sipërfaqe prej 81 mijë ha në vitin 2017, respektivisht 2018. Sipërfaqja më e vogël e kultivuar me grurë ishte në vitin 2014, me vetëm 42 mijë ha. Që nga viti 2014 e deri në vitin 2020, sipërfaqja mesatare e kultivuar me grurë ishte ishte 81 mijë ha në vit.




Figura 6. Kultivimi i grurit në Kosovë gjatë viteve 2014-2019

2.6.2. Prodhimtaria e grurit në Kosovë

Prodhimtaria më e lartë e grurit në vendin tonë u arrit në vitin 2016 në sasi prej 366 mijë ton, Ndërsa prodhimtaria më e ulët e grurit u shënua në vitin 2018, në sasi prej 280 mijë ton, mirëpo në vitin 2019, prodhimtaria e grurit pësoi rritje të vogël, ku prodhimtaria e grurit ishte 285 mijë ton grurë.

Gjatë periudhës ndërmjet viteve 2014-2019, prodhimtaria mesatare vjetore e grurit në vend ishte 248 mijë ton në vit.

Megjithatë, në vitin 2019 u shfaq një rritje e prodhimtarisë së grurit në vlerë (1.6%) më shumë në krahasim me vitin 2018. Mirëpo në krahasim me vitin 2017, prodhimtaria e grurit në vitin 2019 ishte për (5 %) më e vogël.

Tabela 7. Prodhimtaria e grurit në Kosovë gjatë viteve 2014-2019

Viti	Prodhimtaria e grurit (ton)
2014	331,296
2015	304,443
2016	365,651
2017	320,136
2018	280,616
2019	285,350

Burimi: ASK – Regjistrimi i Bujqësisë ('14); Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore ('15,'16,'17,'18'19),

2.6.3. Rendimenti i grurit

Rendimenti i grurit në Kosovë në krahasim me rendimentin e vendeve fqinje si Serbia, Kroacia etj, vazhdon akoma të mbetet shumë i ulët. Në bazë të vlerësimeve nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), vlerësohet se rendimenti mesatar i grurit për ha në Kosovë është 3.7 ton/ha. Rendimenti i ulët i grurit në Kosovë vazhdon të mbetet edhe më tej për shkak të disa arsyeve:

1. Fara jo cilësore e përdorur për mbjellje;
2. Teknologjia jo adekuate dhe e vjetëruar ;
3. Mbjellja e farës me rendiment të ulët, pra fermerët mbjellin farën e grurit e cila jep rendiment të ulët;
4. Pesticidet dhe plehërat e përdorura gjatë dhe pas mbjelljes janë jo-cilësore, me ç'rast nuk ka ndikimin në luftimin e sëmundjeve të grurit;

Rendimenti më i lartë i grurit është arritur në vitet 2016 dhe 2017, me rendiment mesatar në nivel vendi prej 4.1 t/ha në vitin 2016, përkatësisht, me rendiment mesatar në nivel vendi në vitin 2017 prej 3.9 t/ha. Rendimenti më i ulët i grurit për këtë periudhë paraqitet në vitin 2015 dhe 2018 me 3.65 t/ha, ndërsa në vitin 2019 rendimenti mesatar i grurit ishte 3.6 t/ha, që në krahasim me vitin 2018, kishte rritje për 1.4%.

Tabela 8. Rendimenti i grurit në Kosovë t/ha

Viti	Rendimenti i grurit në ton/ha
2014	3.65
2015	3.38
2016	4.10
2017	3.98
2018	3.46
2019	3.65

Burimi: ASK – Regjistrimi i Bujqësisë ('14); Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore ('15,'16,'17,'18'19),

2.6.4. Çmimi për njësi të grurit të importuar

Çmimi doganor i grurit për njësi të importuar në vitin 2014 ishte 0.22 €/kg, që në këtë vit shfaqet edhe si çmimi më i lartë për këto vite, pasuar me rënie të çmimit në vitet në vijim deri në

vitin 2016, me çmim prej 0.15 €/kg. Që nga viti 2017 çmimi i grurit pësoi ngritje graduale, kështu që në vitin 2019 çmimi i grurit ishte 0.20 €/kg.

Tabela 9. Çmimet e importit të prodhimeve bujqësore (grurit), €/kg

Viti	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Çmimi i grurit të importuarar €	0.28	0.29	0.27	0.24	0.31	0.27

Burimi: ASK, çmimet e importit të prodhimeve bujqësore, 2014-2019

2.6.5. Çmimet e fermës të prodhimeve bujqësore (grurit)

Në tabelën në vijim, janë paraqitur çmimet e prodhimeve bujqësore në fermë në periudhën nga viti 2014 deri në vitin 2019.

Tabela 10. Çmimet mesatare vjetore të prodhimeve bujqësore në fermë (grurit), €/kg

Viti	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Çmimi i grurit në fermë	0.26	0.28	0.27	0.21	0.23	0.24

Burimi: ASK <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/cmimet> mesatare vjetore të prodhimeve në fermë/vjetaret-statistikor

Në ekonominë tonë, prodhimtaria vendore në bujqësi nuk mund të arrijë t'i plotësoj nevojat e konsumit, andaj pjesa më e madhe e prodhimeve importohen kryesisht nga vendet fqinje. Edhe pse eksporti ka shënuar rritje në vitet e fundit, megjithatë, sasia e lartë e importit ka ndikuar negativisht në aspektin e zhvillimit ekonomik në vend.

Përmes granteve dhe subvencioneve, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka për qëllim që të ndikoj në rritjen e prodhimtarisë, ngritjen e kualitetit të prodhimeve bujqësore, reduktimin e importit, nga i cili ndikohen edhe çmimet e prodhimeve vendore.

Çmimet mesatare vjetore të grurit në fermë në Kosovë në vitin 2014 ishin për 0.02 € më të ulëta në krahasim me çmimin e grurit nga importi ose për (7%). Çmimet mesatare vjetore të grurit në fermë si dhe çmimet e grurit nga importi ishin pothuajse të njëjta përgjatë vitit 2015 dhe 2016,

Çmimet e grurit nga importi shënuan një rritje të dukshme gjatë vitit 2018, ku çmimet e grurit nga importi ishin për 0.08 € më të larta në krahasim me çmimin të grurit të prodhuar në fermë.

2.6.6 Krahasimi i çmimeve vendore me çmimet në vendet e regjionit dhe BE-së

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur krahasimi i çmimeve të prodhimeve bujqësore, përkatësisht grurit, ndërmjet disa vendeve të Bashkimit Evropian dhe Kosovës. Si rezultat importit të lartë të Kosovës, ndryshimet e çmimeve të grurit në tregun ndërkombëtar ose në vendet e regjionit, ndikojnë direkt në çmimet e tregut të Kosovës.¹⁰

Tabela 11: Çmimet e grurit në Kosovë dhe disa vende të BE-së në vitin 2019, €/kg

Shtetet	Çmimi i grurit €/ kg
Bullgaria	0.15
Çekia	0.17
Greqia	0.19
Hungaria	0.15
Austria	0.14
Rumania	0.15
Kosova	0.18

Burimi: Eurostat; DAESB - MPBZHR

¹⁰ Raporti i Gjellbër i Kosovës (2020).

https://www.mbpzhrvks.net/repository/docs/Raporti_i_Gjelber_202003022021.pdf dhe kalkulime të autorit

Në bazë të dhënave nga tabela e mësipërme, mund të konkludohet se në Kosovë ekzistojnë çmime të cilat janë relativisht të larta në krahasim me vendet e tjera të BE-së. Çmimet e larta të grurit formohen si rezultat i sasisë së ulët të prodhimit vendor, kostos së lartë të prodhimit dhe pjesëmarrjes së lartë të importit. Në krahasim me vendet tjera të rajonit, çmimi i grurit në Kosovë është relativisht më i lartë se në Austri, Rumani, Hungari dhe Bullgari..¹¹




Figura 7. Çmimet e grurit në Kosovë dhe disa vende të BE-së në vitin 2019, €/kg

¹¹ Raporti i Gjellbër i Kosovës (2020).

https://www.mbpzhrks.net/repository/docs/Raporti_i_Gjellber_202003022021.pdf dhe kalkulime të autorit

2.7. Prodhimi bujqësor dhe përdorimi i tij

2.7.1 Përdorimi i tokës bujqësore

2.7.2. Kultivimi i tokës bujqësore në Kosovë

Sipërfaqja e përgjithshme e shfrytëzuar e tokës bujqësore në vitin 2016 ishte 415,826 ha, ndërsa në vitin 2017 dallohet një rritje e lehtë, e cila vazhdon deri në vitin 2018, ku sipërfaqja e kultivuar arrin në 418,582 ha. Rritje të shfrytëzimit të tokës bujqësore kemi edhe në vitin 2019 ku sipërfaqja e kultivuar arriti në 420,141 ha, trend ky që tregon një rritje të sipërfaqes së shfrytëzuar në vitin 2019 në krahasim me vitin 2018 për (0.4%)

Në vitin 2019 në Kosovë sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore ishte 420,141 hektarë (përfshirë tokën e përbashkët). Nga gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore, pjesa më e madhe u përket: livadheve dhe kullosave (përfshirë tokën e përbashkët) me 51.9%; tokës së punueshme, ku arat marrin pjesë me 44.8%; kulturat shumëvjeçare (pemët, vreshtat, fidanët) me 3.0%; dhe kopshtet me 0.3%.

Nga gjithsej tokë e punueshme – ara (188 364.69 ha), pjesa më e madhe është me drithëra 124,198.96 ha (65.9%); bimë foragjere me 37,496.72 ha (19.9%); perime gjithsej (në fushë të hapur, në serra dhe kopshte) janë 9,958.80 ha, prej të cilave perimet në fushë të hapur dhe serra janë 8,836.68 ha (4.7%); patate 3,688.19 ha (2.0%); bishtajore 2,997.00 ha (1.6%); bimë industriale 401.92 ha (0.2%); kultura të tjera 2,580.42 ha (1.4%) dhe tokë djerrinë 8,164.80 ha (4.3%).

Sipas ASK 2019, numri i përgjithshëm i personave të angazhuar në bujqësi në Kosovë ishte: 270,181 persona. Kontributi i përgjithshëm i tyre në punën bujqësore ishte 82,656.98 Njësi të Punës Vjetore (NjPV) (ku 1 NjPV është e barabartë me 1800 orë pune në vit /225 ditë pune/ nga tetë orë në ditë).¹²

¹² <https://ask.rks-gov.net/media/5488/anketa-e-ekonomive-bujqesore-2019-2.pdf> – (parë për herë të fundit me 02.02.2021)

2.7.3 Madhësia e fermave në Kosovë

Gjithsej tokë e punueshme në Kosovë paraqitet të jetë 44.8%, ku përshihet sipërfaqja e tokës, e cila është kultivuar rregullisht me kultura të ndryshme bujqësore, ose është mbjellë me një renditje të caktuar të kulturave. Sipërfaqja e tokës së punueshme e shfrytëzuar i referohet sipërfaqes kryesore gjatë një viti të prodhimit bujqësor. Në vitin 2019, gjithsej toka e punueshme-ara rezulton të jetë 0.11 ha për kokë banori, ndërsa mesatarja e krejt sipërfaqes së shfrytëzuar bujqësore për kokë banori ishte 0.24 ha.¹³

Në Kosovë madhësia e fermës prej 2 deri më pak se 5 ha përfaqëson 35%, të gjithsej sipërfaqes së tokave të punueshme-arave, pasuar nga madhësia prej 5 deri më pak se 10 ha (21%), madhësia 1 deri më pak se 2 ha (16%) dhe madhësitë e tjera me më pak pjesëmarrje, ku madhësia me sipërfaqen më të vogël është ajo prej 0 deri më pak se 0.5 ha.

Rëndësia e fermave individuale është e madhe, megjithatë, rëndësia ekonomike e këtyre fermave është në kundërshtim me mundësitë e tyre të mundshme. Kjo sepse ato janë kryesisht të vogla dhe pa mbështetjen e duhur nga shteti për një periudhë të zgjatur kohe.

Sipas (Jelic, Jovanovic, 2004 dhe të tjerë), puna familjare kryen punën në fermë, e cila rezulton në zvogëlimin e potencialit të punësimit. Sidoqoftë, këto ferma veprojnë kryesisht brenda kufijve të riprodhimit të thjeshtë, me elemente të theksuar të prodhimit natyror dhe të thjeshtë të mallrave¹⁴

¹³ Raporti i Gjellbër i Kosovës 2020 (parë për herë të fundit 22.01.2021)

¹⁴ Nikolic, Olivera; Jelic Miodrag; , Jovanovic Ljubinko , VARIABILITY OF SERBIAN WINTER WHEAT GENOTYPES AND THEIR EVALUATION IN TERMS OF SUSTAINABLE AGRICULTURE 2004)

https://www.researchgate.net/publication/262685011_VARIABILITY_OF_SERBIAN_WINTER_WHEAT_GENOTYPES_AND_THEIR_EVALUATION_IN_TERMS_OF_SUSTAINABLE_AGRICULTURE (parë për herë të fundit 25.01.2021)

Sipa (Muncan, Todorovic, Muncan dhe të tjerë, 2014), madhësia e fermës është thelbësore për efikasitetin e operacioneve në bujqësi, kështu që, mund të konkludohet se me madhësi kaq të pafavorshme fermat vështirë se mund të jenë konkurruese në treg dhe në drejtim të rritjes së konkurrencës.¹⁵

2.8. Konsumi i miellit të grurit dhe grurit në Kosovë

2.8.1 Përlllogaritja e konsumit vjetor të miellit të grurit dhe grurit në Kosovë

Mielli i grurit është një produkt ushqimor me një përdorim masiv. Kërkesat e tregut për të janë të përditshme dhe të vazhdueshme. Tradicionalisht, mielli është një ushqim bazë për shqiptarët. Ai hyn në grupin e produkteve që kanë një konsumim të përditshëm e të vazhdueshëm. Sipas të dhënave të (Raportit të Gjellbër të Kosovës 2020), në Kosovë konsumi mesatar vjetor i grurit për kokë banori është 205 kg.grurë ose 155 kg miell.

Po të kemi parasysh faktet se:

Për 1 kg. bukë konsumohen 0.7 kg. miell. –

Nga 1 kg grur prodhohen afërsisht 0.76 kg miell. –

Popullsia e Kosovës të merret që ka rreth 1.8 milion banorë. Mund të bëjmë llogaritjet dhe parashikimet e mëposhtme lidhur me konsumin e grurit dhe miellit në vendin tonë.

Konsumi ditor i miellit ose grurit për banorë

$0.72 \text{ kg bukë/ditë banorë} \times 0.58 \text{ kg. miell/kg.bukë} = 0.42 \text{ kg miell/ditë.banorë}$

$0.55 \text{ kg miell/ditë banorë} / 0.76 \text{ kg miell/kg.grur} = 0.55 \text{ kg grur/ditë.banorë}$

Konsumi vjetor i miellit ose grurit për banor

$0.42 \text{ kg.miell/ditë.banorë} \times 365 \text{ ditë/vit} = 155 \text{ kg.miell/vit.banorë}$

$0.56 \text{ kg.grurë/ditë.banorë} \times 365 \text{ ditë/vit} = 205 \text{ kg.grurë/vit.banorë}$

¹⁵ Muncan Petar, Todorovic Sasa, Muncan Mihajlo. Profitability of farms directed at crop production (January, 2014).

Konsumi vjetor i miellit ose grurit në tërë vendin

155 kg.miell/vit.banorë x 1,800.000 banorë = 279,000 ton.miell/vit

205 kg.grur/vit.banorë x 1,800,000 banorë = 369,000 ton.grur/vit

Konsumi ditor i miellit ose grurit në shkallë vendi

0.42 kg.miell/ditë.banor x 1.800,000 banorë = 756 ton.miell/ditë

0.56 kg.grur/ditë.banorë x 1.800,000 banorë = 1000 ton.grur/ditë

Sipas përlllogaritjeve nga tabela e mësipërme, mendohet se konsumi i miellit në vend për prodhim buke nuk do të ketë rritje të ndjeshme me kalimin e viteve, për arsye se rritja e popullsisë do të kompensohet deri në një farë mase me uljen e konsumit të bukës, që sipas mendimit të specialisteve të fushës do të vijë duke u ulur në masën 5-10%. Si rezultat kjo e rritjes së nivelit të jetesës, dhe krahas saj rritjes së konsumit të produkteve të tjera ushqimore, që influencojnë në uljen e konsumit të bukës.

Nevojat e popullsisë për miell gruri në shkallë vendi përmbushen nga këto tri burime kryesore:

1. Grurë vendor që përpunohet në miell në fabrikat ekzistuese të vendit
2. Grurë importi që përpunohet në miell në fabrikat ekzistuese të vendit
3. Miell importi

Në tabelën e mëposhtme do të paraqitet sasia dhe vlera e miellit të importuar për periudhën e viteve 2017-2020

2.9. Importi i miellit

2.9.1 Importi i miellit në Kosovë

Tabela 12: Importi i miellit në Kosovë 2017-2020

Viti	Neto kg	Vlera/Çmimi €
2017	30,120,500	5,340,339
2018	19,291,910	5,098,403
2019	19,550,623	5,841,100
2020	27,575,550	8,165,800

Burimi: Dogana e Kosovës, parë për herë të fundit 02.02.2021 dhe kalkulime të autorit

Bilanci i furnizimit me miell në Kosovë, vazhdonte të ishte negativ, andaj mbulesa e deficitit me miell u mbulua nga importi.

Sipas të dhënave nga Dogana e Kosovës, importi i miellit në Kosovë kryesisht sigurohet nga këto vende: Serbia, Hungaria, Rusia dhe Austria.

Sasia më e madhe e importit miellit ishte në vitin 2017, në sasi prej 30 milionë kg, në vlerë prej 5.3 milion €.

Ndonëse sasia e miellit nga importi pësoi ulje në vitin 2018 dhe në vitin 2019, në sasi nga 19 milionë kg, megjithatë, vlera e parasë së shpenzuar vazhdoi të ishte pothuajse e njëjtë, kjo për arsye të ndryshimit të çmimit të miellit, i cili pësoi ngritje deri 30%.

Çmimi i miellit nga importi në vitin 2017 ishte 0.22 €/kg, ndërsa, në vitin 2018 çmimi i miellit pësoi ngritje për 0.08 €/kg. Dhe ky çmim vazhdoi të mbetet i pandryshuar deri në vitin 2020.

2.10 Rishikimi i literaturës

Doktrina e cila pohon se tregtia nxit mirëqënien dhe rritjen ka një trashëgimi të gjatë, e cila daton që nga koha e Adam Smith (1723-1790). Smith, në librin e tij të famshëm “An Inquiry into the Nature and Causes of the Wealth of Nations” (1776)¹⁶, thekson rëndësinë e tregtisë si një mekanizëm që mund të shkaktojë tepricë produkti, dhe si pasojë e zgjerimit të tregjeve ajo mund të ndikojë pozitivisht dhe në shpërndarjen e punës dhe nivelin e produktivitetit. Vendet angazhohen në tregti ndërkombëtare për dy arsye kryesore, ku secila prej tyre kontribuon në përfitimet nga tregtia.

Së pari, vendet tregtojnë sepse janë të ndryshëm nga njëri-tjetri. Ashtu si individët, dhe vendet mund të përfitojnë nga diferencat që kanë, secili duke u përqëndruar në atë që bën më mirë.

Së dyti, vendet tregtojnë për të arritur ekonomitë e shkallës në prodhim. Në këtë mënyrë, vendet tentojnë të specializohen në prodhimin e asaj të mire ku arrihet efikasitet më i lartë, sesa të përpiqen të prodhojnë çdo gjë. Në botën reale modelet e tregtisë ndërkombëtare reflektojnë ndërveprimin e të dy këtyre motiveve. Për këtë arsye, rëndësi të veçantë merr njohja e modeleve kryesore të tregtisë.

Modelet e tregtisë ndërkombëtare kanë evoluar me kalimin e kohës, duke sjellë implikime dhe përfundime të reja mbi tregtinë dhe përfitimet prej saj. Një nga modelet më të thjeshta, që tregon se si ndryshimet midis vendeve i japin jetë tregtisë dhe përfitimeve prej saj, është dhe modeli Rikardian. Duke ndjekur gjurmët e Smith, Rikardo (1772-1823), zhvilloi teorinë e avantazheve krahasuese. Ai tregoi me rigorozitet në librin e tij “Principles of Political Economy and Taxation” (1817), se nën ndikimin e supozimeve të konkurrencës perfekte dhe punëzënies së plotë, vendet mund të mbledhin përfitime në mirëqënie, duke u specializuar në prodhimin e atyre të mirave me kosto oportune më të ulët, dhe duke tregtuar tepricën e produktit mbi kërkesën e brendshme, me kusht që norma ndërkombëtare e shkëmbimit ndërmjet të mirave të shtrihet midis çmimeve të brendshme¹⁷

¹⁶ Smith, Adam. “An Inquiry into the Nature and Causes of the Wealth of Nations” (1776)

¹⁷ Rikardo “Principles of Political Economy and Taxation” (1817)

Në këtë model, puna është i vetmi faktor prodhimi dhe vendet ndryshojnë vetëm nga produktiviteti i punës në industri të ndryshme. Në modelin Rikardian, vendet do të eksportojnë mallra të cilat puna “i prodhon” relativisht në mënyre eficiente dhe importojnë mallra të cilat puna “i prodhon” në mënyrë joeficiente. Më pak fjalë, në këtë rast, modeli i prodhimit të një vendi përcaktohet nëpërmjet avantazheve krahasuese.¹⁸

2.10.1 Historia e teorisë së zëvendësimit të importit

Figurat kryesore në ekonominë e zhvillimit në vitet 1950, ishin Raúl Prebisch, Gunnar Myrdal, W. Arthur Lewis, Albert Hirschman dhe Ragnar Nurkse. Edhe pse këta ekonomistë përgjithësisht ishin kritikë ndaj idesë së tregtisë së lirë, ata kishin pikëpamje çuditërisht të përziera në lidhje me zëvendësimin e importit.

Prebisch ishte pa dyshim mbështetësi kryesor i idesë, megjithatë ai dhe të tjerët ishin ndër të parët që identifikuan disa nga mangësitë e zëvendësimit të importit në praktikë - faktinqë kontrollet e importit nuk ruajnë domosdoshmërisht këmbimin e huaj siç shpresohet, se mbrojtja e normave të tarifave ishte e lartë dhe e ndryshueshme në të gjithë industrinë për arsye që nuk lidhen me ndonjë logjikë të dukshme ekonomike.

Përkundër njohurive që politikat e zëvendësimit të importit ishin zbatuar dobët, disa nga këta mendimtarë të zhvillimit të hershëm vazhduan të besonin se zëvendësimi i importit mund të ishte i dobishëm nëse zbatohet si duhet.

Detyra e thirrjes për reforma të tilla iu la një brezi të ri të ekonomistëve, të cilët ishin përgjegjës për një grup në rritje të hulumtimeve empirike që identifikuan dhe vlerësuan kostot e zbatimit të politikave tregtare kufizuese.¹⁹

¹⁸ JAUPLLARI (TEKA) Soana TREGTIA E JASHTME DHE ZHVILLIMI EKONOMIK NË NDIKIMIN E PROÇESEVE LIBERALIZUESE: RASTI I SHQIPËRISË fq. 4-6

¹⁹ Douglas A. Irwin. THE RISE AND FALL OF IMPORT SUBSTITUTION working Paper 27919 <http://www.nber.org/papers/w27919> NATIONAL BUREAU OF ECONOMIC RESEARCH 1050 Massachusetts Avenue Cambridge, MA 02138 October 2020 (parë për herë të fundit 10.02.2021)

Këta ekonomistë - përfshirë Ian Little, Anne Krueger, Jagdish Bhagwati dhe Bela Balassa filluan të dokumentojnë kostot ekonomike të zëvendësimit të importit dhe të theksojnë përfitimet e një qasjeje më të jashtme, të orientuar drejt eksportit në tregti dhe zhvillimit ekonomik.

Ky ndryshim në opinionin ekonomik nga zëvendësimi i importit në nxitjen e eksportit (ose orientimi i jashtëm) filloi në mesin e viteve 1960 dhe më vonë u regjistrua si pjesë e asaj që Xhoni Uilliamson e quajti "Konsensusi i Uashingtonit" të viteve 1980.

2.10.2 Raúl Prebisch dhe çështja për zëvendësimin e importit

Në vitet 1950, fusha e ekonomisë së zhvillimit u dominua nga disa figura kyçe përfshirë Prebisch, Myrdal, Leëis, Hirschman dhe Nurkse. Në shkallë të ndryshme, ata argumentuan se konkluzionet e nxjerra nga teoritë standarde ekonomike, bazoheshin në supozime që nuk ishin të përshtatshme për rrethanat ekonomike të vendeve në zhvillim. Për më tepër, si Prebisch dhe Hans Krueger argumentuan shkëlqyeshëm, se eksportuesit e produkteve primare do të përjetonin një rënie në kushtet e tyre të tregtisë, duke i detyruar ata të eksportojnë gjithnjë e më shumë në këmbim të gjithnjë e më pak importi. Për më tepër, besohej se çmimet e tregut nuk do të prodhonin ndarjen e duhur të burimeve, sepse pagat e larta në

prodhim (krahasuar me bujqësinë dhe sektorët primar) do të thoshte që industria do të ishte "shumë e vogël" në krahasim me optimumin shoqëror.

Si rezultat, ndërhyrja e qeverisë do të jetë e nevojshme për të alokuar burimet në mënyrë më efikase dhe për të mobilizuar kapitalin e nevojshëm për rritjen ekonomike. Ky ishte konteksti në të cilin u shfaq ideja e zëvendësimit të importit, si një strategji për tregtinë e jashtme për vendet në zhvillim. Në përshkrimin e zëvendësimit të mallrave të importuara me mallra të prodhuara në vend, termi zëvendësim i importit ishte edhe një vëzhgim i asaj që do të ndodhte se si një vend gradualisht fiton kapacitetin për të prodhuar mallra me prejardhje vendore.

Prebisch dhe të tjerët fillimisht e përparuan idenë e zëvendësimit të importit jo si një mënyrë për të zvogëluar importet totale, por si një mënyrë për të zhvendosur përbërjen e importit nga mallrat

e konsumit në mallrat kapitale. Arsyeja për ta bërë këtë ishte më së shumti sepse vendet në zhvillim u përballën me një mungesë të madhe të valutave të huaja pas Luftës së Dytë Botërore.

Importet e mallrave të konsumit mund të zëvendësohen nga prodhimi vendor, por prodhuesit vendor nuk kishin teknologjinë për të prodhuar mallra kapitale, të cilat ende do të duhej të importoheshin.

Prebisch kurrë nuk e mohoi që eksportet ishin kritike për vendet në zhvillim. Eksportet sjellin në vend valutën e huaj që ishte e nevojshme për të paguar për importet e mallrave kapitale që ishin thelbësore për investimet e brendshme. “Prandaj nuk duhet harruar se sa më e madhe të jetë vlera e eksportit nga Amerika Latine aq më e madhe mund të jetë shkalla e zhvillimit të saj ekonomik, "deklaroi ai (1950, 46)²⁰. Rritja e eksportit ishte mënyra kryesore sepse shpenzimet për importe ishin të kufizuara nga fitimet valutore të vëna në dispozicion nga eksportet: “Nëse këto të fundit do të rriteshin mjaftueshëm, atëherë nuk do të ishte e nevojshme për të kufizuar importet". Në deklaratën e tij ndoshta më të qartë për nevojën për politikën e zëvendësimit të importit, Prebisch (1954, 10) shkroi:

“Zhvillimi ekonomik i një vendi kërkon, si rregull të përgjithshëm, një vazhdimësi të zëvendësimit të importeve me prodhim vendas, për aq kohë sa tregjet e huaja nuk kanë mundësi, por pa një përkeqësim të dukshëm në kushtet e tregtisë së vendit, ku eksportet e vendit do të thithin mjaft burime për të kënaqur të gjithë kërkesën e tij për importe.²¹

Ai përsëriti gjithashtu se qëllimi kryesor i zëvendësimit të importit nuk ishte ulja e përgjithshme shpenzimeve për importe, por për të ndryshuar përbërjen e importeve nga mallrat e konsumit në mallrat kapitale.²²

²⁰ Prebisch, Raúl. *International Cooperation in a Latin American Development Policy*. New York: United Nations (1954).

²¹ Prebisch, Raúl. *International Cooperation in a Latin American Development Policy*. New York: United Nations. (1954).

²² Douglas A. Irwin. *THE RISE AND FALL OF IMPORT SUBSTITUTION* working Paper 27919 <http://www.nber.org/papers/w27919> NATIONAL BUREAU OF ECONOMIC RESEARCH 1050 Massachusetts Avenue Cambridge, MA 02138 October 2020 (parë për herë të fundit 10.02.2021)

2.10.3. Ekonomistë të tjerë të zhvillimit mbi zëvendësimin e importit

Ashtu si Prebisch ekonomistë të tjerë të zhvillimit besonin se tregtia e lire nuk ishte politika e duhur për vendet në zhvillim, por ata kishin pikëpamje çuditërisht të ndryshme në lidhje me zëvendësimin e importit. Myrdal ishte një mbështetës kritik, Nurkse ishte skeptic, Levis ishte në mënyrë implicite mbështetëse dhe Hirschman ishte çiltërsisht shpërfillës.

Në librin e tij Teoria ekonomike dhe rajonet e pazhvilluara dhe të tjerë, Myrdal (1957 , 94-95) sulmuan “doktrinën logjike të paqëndrueshme dhe të gabuar të tregtisë së lire”. Sipas pikëpamjes së tij, “këshillat e vendeve të pazhvilluara shpesh nuk jepen falas, nuk duhet abstenuar ndërhyrja në tregtinë e jashtme dhe ndërhyrja në shkëmbimet e huaja, sepse abstenimi në shumicën e rasteve është i barabartë me këshillat për të mos u bezdisur për zhvillimin ekonomik”. Ai refuzoi prerazi se duke përdorur çmimet e tregut si një mënyrë për të gjykuar se si duhet të alokohen burimet. Sepse ato çmime, sipas tij, nuk pasqyrojnë kostot e vërteta sociale.²³

Megjithëse ai e refuzoi tregtinë e lirë si një udhëzues për politikën, Myrdal kurrë nuk e hodhi poshtë rëndësinë e eksporteve. Në një ekonomi ndërkombëtare, Myrdal (1956, 229) argumentoi se “vendi i pazhvilluar ka arsye të fuqishme për maksimizimin e vlerës totale të eksporteve të tij; por aftësia e tij për të eksportuar gjithmonë do të jetë përcaktuesi kryesor i aftësisë së tij për të importuar mallra kapitale, të cilat i duhen në mënyrë që të ndërtojnë, ndër të tjera, industrinë e saj prodhuese.”²⁴

Myrdal (1956, 276) nuk e zhvlerësoi as rëndësinë e importeve, sepse vendet në zhvillim kishin “nevojë të madhe” për blerjen e mallrave. Në të kundërt, Ragnar Nurkse ishte skeptic në lidhje me zëvendësimin e importit në parim, sepse nuk adresonte atë që ai e shihte si pengesë detyruese për zhvillimin. Në problemet e formimit të kapitalit në vendet e pazhvilluara (1953), Nurkse mbrojti një politikë të rritjes së ekuilibruar në të cilën investimet kapitale duhet të rriten në një gamë të industrive për të ndihmuar në diversifikimin e ekonomisë.

²³ Myrdal, Gunnar, Economic Theory and Under-Developed Regions. London: Duckworth. (1957)

²⁴ Myrdal, Gunnar. An International Economy. New York: Harper & Bros. (1956)

Duke vepruar kështu, ai gjithmonë theksoi se pengesat kryesore të akumulimit të kapitalit ishin më shumë në anën e ofertës (nevoja për të rritur kursimet) sesa nga kërkesa (një mungesë e mundësive të investimit). Për këtë arsye, ai ishte i dyshimtë se kufizimet e importit duhet të përdoren për të promovuar prodhimin vendas kur tregjet lokale ishin të vogla, gjë që bëri të ketë më pak mallra të huaja kapitale ²⁵

Për vendet me "furnizime të pakufizuara" të punës, Lewis (1953, 39) argumentoi se "ekziston një justifikim teorik për mbrojtje" nëse fitimet reale në prodhim ishin më të larta se në bujqësi. Ai argumentoi për subvencione të kufizuara ose mbrojtje për industrinë në të cilat ekzistonte të mësuarit duke bërë investime dhe mbrojtje të përgjithshme (për ndoshta 20 vjet) nëse do të kishte të subvencione të jashtme në ekonominë e shkallës në prodhim.

Albert Hirschman ishte kritik i hapur ndaj idesë së zëvendësimit të importit, të paktën gjatë viteve 1950. Në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik, (1968, 123–24), ai argumentoi se "avokatët e mbrojtjes dhe industrializimit "kanë qenë" ngurrues për të vërejtur lidhjen midis importeve dhe industrializimit".²⁶ Hirschman gjithashtu besonte se përqendrimi te zëvendësimi i importit "çon në një nënvlerësim të kontributit thelbësor të eksporteve". Ai përfundoi se "nuk ka asnjë alternativë reale midis promovimit të eksportit dhe zëvendësimit të importit".²⁷ Për më tepër, kishte pak uniformitet në pikëpamjet e tyre: Prebisch favorizonte zëvendësimin e importit, por ishte pesimist i eksportit, Myrdal favorizoi zëvendësimin e importit, por mbështeti promovimin e eksportit dhe Nurkse kundërshtoi zëvendësimin e importit, por ishte një pesimist për eksportin.

Hirschman ishte mbase i vetmi në grup që fillimisht ishte kritik ndaj zëvendësimit të importit dhe mbështetës i nxitjes së eksporteve.

²⁵ Nurkse, Ragnar. *Problems of Capital Formation in Underdeveloped Countries*. Oxford: Basil Blackwell (1953).

²⁶ Lewis, W. Arthur. *Aspects of Industrialization* (1953)

²⁷ Hirschman, Albert O. *The Political Economy of Import-Substituting Industrialization in Latin America* (1968).

Rënia e zëvendësimit të importit si një ide e politikës u përshpejtua pas studimeve që datojnë nga mesi i viteve 1960 ku mori një qasje empirike për të vlerësuar ndikimin dhe koston e zëvendësimit të importit Sigurisht, zëvendësimi i importit si politikë zgjati shumë më gjatë, në shumë vende deri në vitet 1980 kur kriza e borxhit filloi të detyrojë rregullime të mëdha në politikë. Me ngritjen e Konsensusit të Uashingtonit, ekonomistët në ECLA dhe gjetkë të cilët ishin simpatizues me qëllimet e zëvendësimit të importit e zhvendosën theksin e tyre nga kufizimet importit në "neostrukturalizëm".²⁸

Siç tregon Love (2018), kjo doktrinë u përqendrua në arritjen e një shpërndarjeje më të barabartë të të ardhurave, zgjerimin e eksporteve dhe promovimin e ndryshimeve më të shpejta teknologjike. Në vend të përdorimit politikave të qeverisë për të kufizuar importet, ideja ishte që të përdoren politikat industriale për të promovuar më mirë sektorë të caktuar të ekonomisë. Debati mbi politikat e tilla vazhdon edhe sot e kësaj dite.²⁹

²⁸ Love, Joseph. CEPAL, Economic Development, and Inequality. *History of Political Economy* 50, no. S1: 152–71 (2018)

²⁹ Douglas A. Irwin. THE RISE AND FALL OF IMPORT SUBSTITUTION working Paper 27919 <http://www.nber.org/papers/w27919> NATIONAL BUREAU OF ECONOMIC RESEARCH 1050 Massachusetts Avenue Cambridge, MA 02138 October 2020 (parë për herë të fundit 10.02.2021)




Figura 8: Modeli i suksesshëm konceptual i zëvendësimit të importit në ekonominë moderne globale

Burimi: Revista Espacios: www.revistaespacios.com/a18v39n12/a18v39n12p16.pdf – Parë për herë të fundit 22.02.2021.

KAPITULLI 3: METODOLOGJIA DHE METODAT E HULUMTIMIT

3.1 Metodologjia e aplikuar

Punimi është i bazuar kryesisht nga të dhënat primare të fituara nga intervista me pronarët e mullinjëve të miellit, drejtorët e prodhimit, drejtorët financiarë dhe menaxherët e cilësisë nga industritë e prodhimit të miellit të grurit (mulli).

Të dhënat primare (parësore) të fituara nga intervistat, kanë shërbyer për të paraqitur kalkulimin e kostos së përpunimit përkatësisht përfitimit të miellit në mulli. Faktorët kryesorë të cilët janë të lidhur direkt apo indirekt në procesin e përpunimit të grurit, fitimin bruto dhe neto nga shitja e miellit, si dhe raportin e shitjes së llojeve (tipeve) të miellit në treg si tipe të veçanta apo si pjesë e tërësisë.

Pjesa tjetër e hulumtimit është e bazuar në të dhëna sekondare (dytësore) të marra nga literatura e autorëve të huaj dhe vendor. Të dhënat statistikore të paraqitura të cilat flasin mbi kultivimin e grurit, rendimentin, çmimet e miellit, konsumin e miellit në vend, sasinë e përgjithshme të miellit të importuar, janë marrë nga të dhënat e publikuara nga institucionet përkatëse siç janë: Dogana e Kosovës, Raporti i Gjellbër i Kosovës, Instituti GAP , Agjencia e Statistike të Kosovës.

Hulumtimi është i bazuar në disa metoda: në metodën historike, në të cilën përshkruhen të dhënat brenda periudhës 4-6 vjeçare; në metodën deskriptive, ku përshkruhen detajet mbi temën e caktuar; metoda krahasimore, në të cilën përshkruhet krahasimi i variablave ndërmjet Kosovës dhe vendeve të rajonit.

KAPITULLI 4: REZULTATET DHE DISKUTIME

4.1 Marrëdhënia ndërmjet çmimit dhe cilësisë

Në një situatë konkurruese një çmim më i lartë pasqyron koston më të lartë për njësi të prodhimit- Nëse kjo nuk do të ndodhte kështu, pra nëse kompanitë do të kishin fitime jonormale, atëherë në treg të do të krijoheshin firmat e reja, sepse secili do të pretendonte fitime të larta me kosto te ulët. Duke supozuar efikasitetin e prodhimit, kostoja për njësi është më e lartë nëse cilësia është më e mirë (materiale më të mira, dizajne më të mira etj). Prandaj, në një treg konkurrues mund të pritët çmimi dhe cilësia (objektive), d.m.th. cilësia e matur nga teknikat e standardizuara dhe efikase. Marrëdhënia aktuale midis çmimit dhe cilësisë në treg mund të jetë më e dobët sesa supozohet në teorinë ekonomike të tregjeve konkurruese.

Konsumatorët e mirëinformuar do 'disiplinonin' tregun, në mënyrë që diferencat e çmimeve të pasqyrojnë ndryshimin e vërtetë në cilësi. Në këtë mënyrë, konsumatorët të informuar dobët mund të përfitojnë indirekt, nga informacione të mbajtura nga të tjerët. Kjo do të tentonte ta dobësoj ose edhe përmbys marrëdhënien pozitive midis çmimit dhe cilësisë.³⁰

Sa i përket aspektit mbi përcaktimin e marrëdhënies ndërmjet çmimit dhe cilësisë, pjesa dërmuese e konsumatorëve si parametër kryesor mbi të cilin vendosin për të blerë produktin në këtë rast miellin, është cilësia e miellit. Cilësia e miellit është faktori determinues mbi të cilin vlerësohet vlera e miellit dhe jo çmimi. Kjo për arsye se cilësia e miellit lidhet direkt me llojin e produktit të dëshiruar që konsumatori dëshiron të fiton nga lloji i miellit. P.sh konsumatorët të cilët preferojnë të gatujnë bukë, atëherë ata zgjedhin miellit tip 500. Konsumatorët e interesuar për gatimin e piteve, kifleve zgjedhin llojin adekuat të miellit, në këtë rast miellin e tipit 400. Ndërsa konsumatorët të cilët preferojnë miell për gatimin e byrekut, picës ose bakllavës, si miell adekuat e zgjedhin miellin special. Në bazë të vlerësimeve mund të konkludojmë se, mënyra e përdorimit të miellit nga konsumatori është përcaktuesi kryesor, pra cilësia e miellit është faktor më i rëndësishëm se sa çmimi i miellit.

³⁰ STEENKAMP, Jan Benedict E.M. The relationship between price and quality in the marketplace, (1986)

4.2 Cilësia përcakton çmimin

4.2.1 Përcaktimi (formulimi) i çmimit në miell dhe grurë

Në industrinë e përpunimit të drithërave, përkatësisht në përpunimin e grurit, cilësia e grurit është faktori kryesor apo përcaktuesi primar i çmimit shitës të miellit në treg.

Çmimi shitës i miellit në treg, varet nga cilësia e miellit, destinimi apo tipi (lloji i miellit)

4.2.2 Faktorët përcaktues të çmimit të grurit janë:

- Çmimi blerës i grurit.
- Kërkesa dhe oferta në treg për grurë,
- Sipërfaqja e përgjithshme e grurit të mbjellur (ndikon në çmimin e grurit)
- Vendi i origjinës së blerjes së grurit (sa më larg të blihet gruri, shpenzimet e transportit janë më të larta)
- Vetitë fiziko-kimike të grurit të blerë
- Vetitë reologjike të grurit të blerë
- Lloji i grurit të blerë (gruri standard apo *triticum aestivum* i cili është i destinuar për përfitimin e miellit Tip 400, Tip 500, Tip 850, Tip 1000 ose dhe miell tip integral, është grurë me çmim më të lirë.
- Gruri premium *triticum aestivum durum* (grurë i destinuar për miell për gatime të byrekut, picës, kroasanteve është me çmim më të lartë)

4.2.3 Faktorët përcaktues të çmimit të miellit janë:

- Tipi i miellit (destinimi i tij);
- Rrezja e ekstraktimit të tij në mulli;

- Kualiteti i miellit të prodhuar;
- Përmbajtja e proteinave në miell;
- Përmbajtja e glutenit në miell;
- Përdorimi i miellit nga konsumatorët (miellrat me përdorim të gejërë tip 400, tip 500, tip integral) janë miellra me përdorim më të lartë se sa miellrat premium (të destinuar për byrek, pica, kroasante).
- Marka e miellit (goodwill, besimi i konsumatorit tek kompania).

4.3 Përcaktimi (formulimi) i çmimit shitës të miellit në tregun Kosovar

Në bazë të studimeve të bëra, si dhe në bazë të dhënave të fituara nga intervistat, përcaktimi i çmimit të miellit varet nga shumë faktorë, ndër të cilët janë çmimi i grurit, transporti, ekstraktimi, cilësia e miellit të prodhuar, shkalla e përdorimit dhe tipi i miellit.

Në këtë hulumtim do të paraqiten parametetrat kryesore të cilët përbëjnë koston e prodhimit, përkatësisht çmimin shitës të miellit në Kosovë.

Si rast studimi, do të merren 3 tipet më të zakonshme të miellit, të cilat konsumohen në sasi më të madhe nga konsumatorët vendas: *miell Tip 400*, *miell Tip 500* si dhe *miell Tip Special (premium)*.

4.3.1 Përcaktimi (formulimi) i çmimit shitës të mielli Tip 400

Miell tip 400 është lloj i miellit i përfituar nga bluraja e kokrrës së grurit, ku kufiri maksimal i përmbajtjes së hirit (mbetja e materieve minerale pas djegies së miellit në 900 shkallë celsius është 0.45).

Në tregun vendor, mielli Tip 400 gjindet i ambalazhuar kryesisht në paketime me peshë 1kg, 5kg, 25 kg.

Çmimi shitës në treg i miellit Tip 400 kryesisht është rreth 10% më i lartë në krahasim me miellin T-500, dhe arsyet kryesore të kësaj difference janë:

Kostoja e prodhimit të miellit është më e lartë sepse:

Çmimi blerës i grurit në treg, i cili përdoret për përfitimin e miellit Tip 400 është rreth 10% më i lartë në krahasim me çmimin e grurit, i cili përdoret për prodhimin e miellit Tip 500.

Gjatë procesit të bluarjes së grurit në mulli, përqindja e ekstraktimit gjatë përfitimit të miellit Tip 400 është më e vogël në raport me miellin Tip 500, që nënkupton se pas bluarjes së 1000 kg grurë, përfitohen 600 kg miell dhe 400 kg krunde.

Çmimi shitës i miellit në treg është më i lartë për arsye se:

- Vetitë fiziko-kimike duhet t'i pëgjigjen standardit, që do të thotë se mielli duhet të mos ketë erë myku, duhet të ketë ngjyrë të zakonshme të miellit, të mos ketë aromë, të ketë shije të miellit etj, po ashtu, në aspektin e vetive reologjike të miellit, mielli Tip 400, zakonisht duhet të përmban përmbajtje më të lartë të proteinave, glutenit etj, në raport me miellin Tip 500

- Vetitë Fiziko-kimike të cilat duhet të përmbajë mielli tip 400 janë:

- Përmbajtja e hirit max. 0.450 * SH ISO 2171

- Përmbajtja e proteinës min.9 % * SK EN ISO 20483

- Përmbajtja e glutenit të njomë min.24% * SK EN ISO 21415-1

Vetitë reologjike të brumit:

- Grupi kualitativ i miellit duhet të jetë min.B1* S SH ISO 5530-2

- Shkalla e zbutjes max 80 NJ.F * S SH ISO 5530-2

- Energjia min 80 cm²* S SH ISO 5530-2

- Shtrirja min.120 mm * S SH ISO 5530-2

*Shih aneks 1

Përveç vetive fiziko-kimike dhe reologjike, disa nga faktorë tjerë me rëndësi, të cilët ndikojnë direkt në përcaktimin e çmimit të miellit në treg, janë kërkesa e konsumatorit, ose thënë ndryshe sasia mujore apo vjetore e këkesës për miell nga konsumatorët.

Në bazë të specifikave të përbërjes, mielli tip 400 është miell i prodhuar në mënyrë specifike pasi që përdorimi i tij është i destinuar për gatime, të cilat nuk kanë nevojë për volum të lartë të brumit, mirëpo për bardhësi dhe më shumë aftësi të shtrirjes së brumit gjatë gatimit.

Prandaj, mielli tip 400 kryesisht gjen përdorim si miell për gatimin e kifleve, piteve apo ëmbëlsirave. Përdoruesit (konsumatorët) kryesorë të këtij mielli janë: fabrikat për gatimin e kroasanteve, petëve, dhe pjesa tjetër, furrëtarët dhe ekonomitë familjare.

Në bazë të pjesëmarrjes së shitjes e sasisë së përgjithshme të miellit e cila shitet në treg, mielli tip 400 shitet rreth 30-40% më pak, në raport me miellin tip 500,

Si rrjedhojë, arsyet kryesore të cilat ndikojnë në diferencën e çmimit shitës të miellit T-400 në raport me miellin tip 500 janë kualiteti më i lartë i miellit, dhe pjesëmarrja më e vogël e shitjes në treg.

4.3.2 Përcaktimi (formulimi) i çmimit shitës të miellit T-/Special (premium)

Mielli i tipit special, dallon nga të gjitha llojet e tjera të miellrave të prodhuar apo plasuar në treg. Miell tip special është i veçantë, për arsye sepse tipet e tjera të miellrave si mielli Tip 400, Tip 500, Tip 850 apo mielli integral janë miellra të zakonshëm, të cilat përfitohen nga bluarja e grurit standard apo (*Triticum aestivum*), ndërsa mielli special përfitohet vetëm nga bluarja e grurit premium apo siç quhet (*Triticum durum*).

Në tregun tonë, mielli special mund të gjëndet i ambalazhuar në paketime: 1kg; 5kg dhe 24 kg.

Në aspektin e vlerave reologjike dhe vetive fiziko-kimike, mielli special dallon nga miellrat e zakonshëm sepse, në krahasim nga mielli i zakonshëm, mielli special përgjithësisht duhet të përmban përqindje dukshme më të lartë të proteinave në miell, min.12%, glutenit min.31%, hiri max.0.450 etj

Po ashtu, në aspektin e vlerave të fituara gjatë analizës reologjike, parametrat reologjike të miellit po ashtu dallojnë shumë, për arsye se gjatë analizës reologjike, mielli special duhet t'i takojë grupit kualitativ A, shkalla e zbutjes në miell duhe të jetë max. 50, energjia min. 140 cm².

Faktorët kryesorë që ndikojnë në formulimin e çmimit te mielli Special (premium) janë:

Çmimi blerës në treg i grurit special rezulton rreth 30% më i lartë në raport me çmimin e grurit standard, prandaj, si pasojë e kësaj, çmimi më i lartë i grurit reflekton që çmimi i miellit special do të rezultojë të jetë 30% më i lartë në raport me çmimet e miellrave tjerë të fituar nga gruri standard.

Gruri special nuk kultivohet në Kosovë dhe pothuajse askund në Ballkan. Prandaj importi i grurit premium në Kosovë sigurohet kryesisht nga importi nga dy vende kryesore, nga Austria dhe Hungaria. Fakt ky që, importi i grurit nga këto vende është dhe një faktor shtesë i cili ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e shpenzimeve të transportit më të lartë për 40%, përkatësisht në rritjen e kostos së miellit.

Përqindja e ekstraktimit gjatë bluarjes së grurit premium në miell në mulli është 60%, që nënkupton se pas bluarjes së 1000 kg grur special, përfitohen 600 kg miell special dhe 400 kg krunde.

Në fund, faktor tjetër me rëndësi i cili ndikon në ndryshimin(diferenë) e çmimit të miellit special ndaj miellrave të tjerë, është plasmani i miellit në treg apo sasia totale e shitjes së miellit , në raport me totalin e miellrave të tjerë në treg.

Mielli special përfaqëson rreth 20% nga shitja e përgjithshme të miellit, për arsye se, tregu i konsumatorëve është me unik, pjesa më e madhe e konsumatorëve janë furrëtarët, apo industritë ushqimore të cilat miren gatimin e burekut, pices, kroasantëve, petëve për pite, bakllavës. Ndërsa, një pjesë shumë e vogël e konsumatorëve janë ekonomitë familjare.

Vetitë Fiziko-kimike të cilat duhet të përmbajë mielli tip special janë:

- Përmbajtja e hirit max. 0.45 * SH ISO 2171
- Përmbajtja e proteinës min.12 % *SK EN ISO 20483

- Përmbajtja e glutenit të njomë min. 31% * SK EN ISO 21415

Vetitë reologjike:

- Grupi kualitativ i miellit duhet të jetë min.A2* S SH ISO 5530-2

- Shkalla e zbutjes max 50 * S SH ISO 5530-1

- Energjia min 120 cm²* S SH ISO 5530-2

- Shtrirja min.150 mm * S SH ISO 5530-2

- Shih aneks 2

4.3.3 Përcaktimi (formulimi) i çmimit shitës te mielli T-500

Mielli tip 500 është mielli më i zakonshëm dhe me përdorimin më të lartë në tregun vendor, për arsye se, pjesa dërmuese e popullsisë konsumojnë bukë, prandaj mielli tip 500 është miell i destinuar kryesisht për gatimin e bukës.

Në treg, mielli tip 500 mund të gjendet i amabalazhuar në paketime 1kg; 5kg; 10 kg, 25kg si dhe 50kg.

Sa i përket çmimit shitës, çmimi shitës i miellit Tip 500 është rreth 10% më i lirë në raport me çmimin e miellit T-400, dhe arsyet kryesore të diferencës në çmim janë:

Kostoja e prodhimit është më e ulët për arsye se:

- Çmimi blerës i grurit në treg, i cili përdoret për përfitimin e miellit Tip 500 është rreth 10% më i lirë në raport me grurin që përdoret për prodhimin e miellit Tip 400.

-Përqindja e ekstraktimit të miellit në mullir është më e lartë te mielli Tip 500 në raport me miellin Tip 400, që nënkupton se pas bluarjes së 1000 kg grurë, përfitohen 700 kg miell dhe 300 kg krunde.

Çmimi shitës në treg i miellit tip 500 është më i lirë për arsye se:

-Vetitë fiziko-kimike të miellit duhet t'i pëgjigjen standardit, që do të thotë se mielli duhet të mos ketë erë myku, duhet të përmban ngjyrë të zakonshme të miellit, të mos përmban aromë, të përmban shije të miellit etj. Mirëpo, vetitë reologjike të miellit tip 500 janë relativisht më të dobëta se tek mielli Tip 400 sepse, mielli Tip 500 përmban përmbajtje më të vogël të proteinave, glutenit etj.

Vetitë Fiziko-kimike të cilat duhet të përmbajë mielli tip 500 janë:

- Përmbajtja e hirit max. 0.550 * SH ISO 2171
- Përmbajtja e proteinës min.9 % *SK EN ISO 20483
- Përmbajtja e glutenit të njomë min.23% * SK EN ISO 21415

Vetitë reologjike:

- Grupi kualitativ i miellit duhet të jetë min.B2* S SH ISO 5530-2
- Shkalla e zbutjes max 100 * S SH ISO 5530-2
- Energjia min 50 cm²* S SH ISO 5530-2
- Shtrirja min.100 mm * S SH ISO 5530-2

Përveç vetive fiziko-kimike dhe reologjike, njëri ndër faktorët kryesorë i cili ndikon në përcaktimin e çmimit të miellit në treg, pra përcakton diferencën e çmimit të miellit në treg është kërkesa e konsumatorit ose sasia mujore apo vjetore që kompania arrin të shes miellin në treg, p.sh:

Mielli tip 500 është miell i prodhuar sipas specifikave, në atë mënyrë që përdorimi i tij të jetë kryesisht për gatime të cilat kanë nevojë për volum të lartë të brumit, kryesisht për bukë.

Prandaj përdorimi i miellit tip 500 është shumë i lartë tek ekonomitë familjare për gatimin e bukës, dhe ky miell më rallë përdoret si miell për gatimin e kifleve, piteve apo ëmbëlsirave,

Sipas pjesëmarrjen së shitjes së përgjithshme të miellit në treg, mielli tip 500 është mielli më i shitur në treg në raport rreth 30-40% më shumë në krahasim me miellin tip 400, dhe 60-70% më shumë se mielli Tip Special

Pra, arsyet kryesore të diferencës (ndryshimit) të çmimit shitës të miellit T-500 në krahasim me miellin tip 400 janë kualiteti i grurit për bluarje relativisht më i dobët, dhe sasia më e lartë e shitjes në raport me tipet e tjera të miellit.

*Shih aneks 3

Vërtetimi i hipotezave

Hipoteza 1

4.4 Konkluzionet mbi marrëdhënien ndërmjet cilësisë dhe çmimit

Gjetjet tregojnë se për shumicën e produkteve çmimi dhe cilësia objektive janë të ndërlidhura pozitivisht., pra korrelacionet ishin pozitive. Cilësia më e mirë, mesatarisht, komandon një çmim më të lartë.

Mençuria konvencionale se 'ju merrni atë që paguani' nuk është gjithmonë e vërtetë. Korrelacionet e cilësisë së çmimeve ndryshojnë me kalimin e kohës. Mund të theksohet se korrelacionet ishin më të ulëta kur niveli i inflacionit ishte mjaft i lartë. Në rastet e inflacionit të lartë, ndryshimi në korrelacionin ndërmjet cilësisë dhe çmimit u vunë re gjithashtu në të gjitha produktet. Korrelacionet ishin më të larta për produkte të qëndrueshme sesa për ato të paqëndrueshme. Më tej, korrelacioni midis çmimit dhe cilësisë provon se produkti lidhet pozitivisht me shkallën e ndryshimit të çmimit për atë produkt. Faktorët përcaktues janë: informacioni i konsumatorit mbi cilësinë e produktit dhe përvoja e konsumatorit mbi produktin. Të dy përcaktuesit lidhen me shtrirjen e kërkimit të konsumatorit për informacionin e produktit.³¹

Çmimi i miellit në treg është i lidhur pozitivisht me kualitetin e tij. Sa më kualitativ të jetë mielli, aq më i lartë do të jetë çmimi i tij. Përveç kualitetit të miellit, faktori tjetër që ndikon në

³¹ STEENKAMP, Jan Benedict E.M. The relationship between price and quality in the marketplace, (1986)

formulimin e çmimit shitës është dhe sasia kërkesës për atë miell, pra sasia e shitjes së tipit të caktuar të miellit, dhe se në shumicën e rasteve, edhe përkundër se cilësia e miellit mund të jetë e lartë, me rritjen e kërkesës, çmimi mund të pëson ndryshime dhe anasjelltas.

Tani rezultatet janë të qarta. Cilësia e miellit dhe shkalla e përdorimit sasia e kërkesës) e miellit nga konsumatorët janë faktorët kryesorë në përcaktimin e çmimit të tij.

4.5 Shpenzimet (kostoja) e përfitimit të miellit në Kosovë

4.5.1 Shpenzimet (kostoja) e përfitimit të miellit Tip 500

Tabela 13. Kostoja e përpunimit të grurit vendor, për përfitimin e miellit T-500

Shpenzimet për përpunimin e 1 ton/ grur	Sasia/ ton	Kosto €	Totati €
Çmimi i grurit	1	180	180
Transporti i grurit	1	2	2
Rryma	1	7	7
Ambalazha- thasë miell	1	5	5
Ambalazhimi në thasë mielli	1	2.5	2.5
Pasurimi i miellit	1	1.5	1.5
Pagat e punëtorëve	1	9	9
Shpenzime administrative	1	5	5
Amortizimi	1	7	7
Shpenzimet tjera		3	3

Totali

222

Burimi: M&Silloso, kalkulimi i autorit

Pra, kostoja e përgjithshme për përpunimin e 1 ton grurë, për përfitimin e miellit T-500 është 222 €

Çmimi mesatar i miellit T-500 në tregun vendor, në ambalazhë 25kg gjatë viteve të fundit ishte 7.50 €, pra që 1 kg miell kushton:

$$7.5 \text{ €} / 25 \text{ kg} = 0.30 \text{ €/kg miell}$$

Rrezja e ekstraktimit të grurit standard në mulli për përfitimin e miellit T-500 është 70%, pra nga 1000 kg grurë përfitohen 700 kg miell.

$$700 \text{ kg miell} \times 0.30 \text{ €} = 210 \text{ €}$$

$$300 \text{ kg krunde} \times 0.09 \text{ €} = 27 \text{ €}$$

$$\text{Ndryshimi (Fitimi Neto)} = \text{Fitimi Bruto} - \text{Kostoja e Prodhimit} = 237 - 222 = 15$$

Fitimi nga shitja e 1 Ton miell T-500 është 15 €

4.5.2 Shpenzimet (kostoja) e përfitimit të miellit Tip 400

Tabela 14. Shpenzimet (kostoja) për përfitimin e miellit Tip 400

Shpenzimet për përpunimin e 1 ton/ grurë	Sasia/ ton	Kosto €	Totali €
Çmimi i grurit	1	185	185
Transporti i grurit	1	2	2
Rryma	1	7	7
Ambalazha- thas miell	1	5	5

Ambalazhimi në thas i krundeve		2.5	2.5
Pasurimi i miellit	1	1.5	1.5
Pagat e punëtorëve	1	9	9
Shpenzime administrative	1	5	5
Amortizimi	1	7	7
Shpenzimet tjera		3	3
Totali			227

Burimi: M&Sillosi, Kalkulime të autorit

Në bazë të përlllogaritjeve, kostoja e përgjithshme për përpunimin e 1 ton grurë, për përfitimin e miellit T-400 është 227 €

Çmimi mesatar i shitjes në treg e miellit T-400 në ambalazhë 25 kg gjatë viteve të fundit ishte 8.75 €, pra:

$$8.75 \text{ €} / 25 \text{ kg} = 0.35 \text{ €/kg miell.}$$

Rrezja e ekstraktimit të grurit standard në mulli për përfitimin e miellit T-400 është 60%, pra nga 1000 kg grurë përfitohen 600 kg miell.

$$600 \text{ kg miell} \times 0.35 \text{ €} = 210 \text{ €}$$

$$400 \text{ kg krunde} \times 0.09 \text{ €} = 36 \text{ €}$$

$$\text{Ndryshimi} = (\text{Fitimi Neto}) = \text{Fitimi Bruto} - \text{Kostoja e Prodhimit} = 246 - 227 = 19$$

Fitimi nga shitja e 1 ton miell T-400 është 19 €

4.5.3 Shpenzimet (kostoja) e përfitimit të miellit Tip special (Premium)

Tabela 15. Shpenzimet (kostoja) për përfitimin e miellit Tip Special - (Premium)

Shpenzimet për përpunimin e 1 ton/ grurë	Sasia/ ton	Kosto €	Totati €
Çmimi i grurit	1	235	235
Transporti i grurit	1	5	5
Rryma	1	7	7
Ambalazha- thasë mielli	1	5	5
Ambalazhimi në thasë krundesh		2.5	2.5
Pasurimi i miellit	1	1.5	1.5
Pagat e punetorëve	1	9	9
Shpenzime administrative	1	5	5
Amortizimi	1	7	7
Shpenzimet tjera		3	3
Totali			280

Burimi: M&Silloso dhe kalkulime të autorit

Gjithnjë sipas përlllogaritjeve, kostoja totale për përpunimin e 1 ton grurë, për përfitimin e miellit T-Special (premium) është 280 €

Çmimi mesatar i miellit T-special në ambalazh 24 kg gjatë viteve të fundit ishte 11 €, pra:

$$11 \text{ €} / 24 \text{ kg} = 0.46 \text{ €/kg miell}$$

Rrezja e bluarjes së grurit special në mulli për përfitimin e miellit special është 60%, pra nga 1000 kg grurë përfitohen 600 kg miell.

600 kg miell x 0.46 € = 276 €

400 kg krunde x 0.09 E = 36 €

Ndryshimi = (Fitimi Neto) = Fitimi Bruto-Kostoja e Prodhimit = 312-280=32

Fitimi nga shitja e 1 ton miell Special është 32 €




Figura 9: Fitimi neto në Euro nga shitja e 1 ton miell

Hipoteza 2

4.6 Poltika e zëvendësimit të importit

4.6.1 Zëvendësimi i importit të miellit në Kosovë

Për shkak të hendekut të madh ndërmjet importit dhe eksportit të miellit në Kosovë, zëvendësimi i importit duhet të parashihet gjithnjë e më shumë si një nga fushat prioritare

të politikës ekonomike të shtetit. Aktualisht, Kosova akoma nuk ka filluar planifikimin e ndonjë strategjie konkrete në lidhje me këtë dukuri, megjithatë akoma është herët për të nxjerrë ndonjë konkluzion në lidhje me suksesin apo dështimin eventual në rast të zbatimit të politikës së zëvendësimit të importit të miellit.

Në rast se Kosova do të vendos të përdorë këtë politikë, atëherë mund të shmangë gabimet e bëra nga vendet e tjera dhe, dhe nëse është e mundur, të arrijë të identifikojë faktorët për suksesin e tyre, përshtatjen e tyre me kushtet e përmirësimit të bilancit si dhe përfshirjen në kohë të duhur.

Prandaj, është e mundur për të analizuar përvojën e akumuluar, për të përmbledhur rezultatet e arritura në mënyrë që të zhvillojë rekomandime për zbatimin e politikës së zëvendësimit të importit në Kosovë

Themelet teorike të zëvendësimit të importit si bazë e "industrializimit që zëvendëson importin" u vunë nga ekonomisti argjentinas R. Prebisch dhe ekonomisti suedez G. Myrdal në vitet 1950. Këta ekonomistë konsideruan masat proteksioniste nga ana e shtetit si një bazë solide për zhvillimin e industrisë e vendeve në zhvillim.

Për të arritur këtë qëllim, tarifat, kuotat, rregullimi i monedhës, rregullimi i çmimit të faktorëve të prodhimit dhe normave të interesit, si dhe subvencionet direkte, u përdorën në formën e përfitimeve tatimore, investimeve direkte në krijimin e industrive të reja, përfitimet në sigurimin e huave bankare, si dhe përfitimet në zbatimin e kontratave të importit.

4.6.2 Instrumentet e Politikës Tregtare

Në drejtim të rrugës së saj të integrimit në BE dhe anëtarësimit në OBT, edhe Kosova i ka përcjellur trendet ndërkombëtare të politikave tregtare, duke i mbajtur detyrimet doganore në nivele të ulëta. Tani për tani, në Kosovë ekziston një tarifë 10% në importe dhe akcizë në importe që varion nga 10 në 50% të vlerës së produktit. Disa produkte, në veçanti lëndët e para që përdoren në prodhim, nuk i nënshtrohen detyrimeve doganore, me qëllim të stimulimit të prodhimit vendor. Megjithatë, anëtarësimi i Kosovës në CEFTA, marrëveshjet e tregtisë së lirë,

dhe MSA-ja e nënshkruar kohë më parë, e obligojnë vendin që të mbajë tarifa zero për shumicën e produkteve.

Duke pasur në konsideratë se pjesa më e madhe e konsumit të vendit varet nga importet dhe kostot e produkteve finale të cilat asociohen me tarifat e importit, është më e preferueshme që politikat e vendit të drejtohen drejt krijimit të një ambienti më të favorshëm afarist që mundëson konkurrencën dhe zhvillimin e sektorit privat, duke shmangur nevojën për përdorimin e instrumenteve klasike të politikës tregtare, siç janë tarifat.

Në këtë aspekt, një çështje tjetër që duhet marrur parasysh është që ekonomia e Kosovës është lojtar relativisht i vogël në tregun ndërkombëtar dhe si i tillë nuk e ka fuqinë e nevojshme ekonomike në mënyrë që të vendosë tarifa pa i'u kanosur rrezikut të masave reciproke.³²

4.7 Zëvendësimi i Importit

Si një koncept që ka për qëllim të fuqizojë insdutrinë vendore duke i limituar importet, zëvendësimi i importit ishte një ndër instrumentet tregtare më të përdorura deri në vitet 1980. Më saktësisht, kjo politikë kërkon mbështetje të industrive të reja nën arsyetimin se pas një periudhe kohore të njëjtat do të jenë në gjendje të konkurrojnë ndërkombëtarisht. Praktika ka treguar se shtetet të cilat kanë ndjekur politika të tilla janë zhvilluar në mënyrë të kondiserueshme më pak, në krahasim me të tjerat. Pikëpamjet janë të ndara kur konsiderohet se a duhet Kosova të ndjekë një politikë të tillë tregtare. Parimet e ekonomisë së hapur të tregut, përfshirë këtu hapjen drejt tregtisë ndërkombëtare janë të rrënjosura në Kushtetutën e Kosovës. Duke marrë parasysh synimet e vendit për njohje ndërkombëtare, trende të tilla janë ndjekur nga Qeveria e Kosovës në të kaluarën. Në njëërën anë, vështirësitë për qasjen në financa, informaliteti, dhe dështimet e tregut lënë të kuptohet se ekziston arsyetimi që institucionet qeveritare të implementojnë politika për zëvendësimin e importit në vend. Mirëpo, një mënyrë më e qëndrueshme për përmirësimin e bilancit tregtar do të ishte përmes përmirësimit të ambientit afarist, i cili rrjedhimisht do të krijonte kushtet për zhvillim të kompanive private. Mbështetja e industrive vendore që ato të

³² <https://www.amchamksv.org/wp-content/uploads/2020/02/Analiz%C3%AB-Tematike-Tregtia.pdf> (pare për here të fundit me 01.02.2021)

fitojnë përparësinë e tyre konkurruese, ka qenë një kërkesë e vazhdueshme e disa sektorëve privat në Kosovë. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural ka qenë një nga institucionet që ka mbështetur me grante disa sektorë bujqësor dhe të përpunimit të ushqimit në vend, me qëllim të përmirësimit të kapaciteteve të tyre për mbulim të tregut vendor. Maqedonia dhe Serbia janë dy nga vendet rajonale të cilat kanë implementuar subvencionimin e drejtpërdrejtë dhe grantet për komunitetin e biznesit. Për sa i përket formave të tjera të zëvendësimit të importit, me nënshkrimin e MSA-së, Kosova ka përcaktuar koncesionet e saja lidhur me produktet të cilat vendi ka potencial t'i prodhojë. Në këtë aspekt, rreth 14 produkte kosovare do t'i nënshtrohen tarifave doganore nën MSA. Masa të tjera mbrojtëse në import nuk ekzistojnë momentalisht, mirëpo disa raste të aplikimit të tyre janë shënuar për periudha të shkurta në të kaluarën.³³

Rezultatet nga analiza e zbatimit të politikës së zëvendësimit të importit në vendet e tjera ka treguar se shpesh sjell përfitime për vendin. Duke përmbledhur ecurinë historike, mund të formulohen konkluzionet kryesore vijuese:

1. Zbatimi i strategjisë ekskluzivisht të orientuar nga zëvendësimi i importit mund të rezultojë jo vetëm në rritjen e prodhimit industrial, por gjithashtu në krizën e zgjatur. Sipas përvojës së Amerikës Latine, kufizimet e importit e bëjnë atë e mundur për të arritur një efekt pozitiv vetëm për një periudhë të shkurtër kohore. Megjithatë, në mungesë të konkurrencës, prodhimi industrial gradualisht bëhet i paefektshëm, duke shkaktuar një rritje të çmimeve..

2. Bashkëpunimi midis shtetit dhe fermerëve, pronarëve të mullirëve është i domosdoshëm kur zgjedhja e një strategjie, por zbatimi i saj duhet të kontrollohet në mënyrë rigoroze nga qeveria e vendit.

Pluralizmi në zgjedhjen e strategjisë së zëvendësimit të importit ndërmjet të dyve institucionet themelore lejojnë ruajtjen e një mjedisi konkurrues, siguron falas

zhvillimi i personalitetit, bën të mundur marrjen e fitimit maksimal.

³³ STEENKAMP, Jan Benedict E.M. The relationship between price and quality in the marketplace, (1986)

Në të njëjtën kohë, koncepti, në të cilin shteti merr pozitën supreme në çështje të diskutueshme, dhe, duke qenë një rregullator politik, merr iniciativën në negociata, mundëson autoritetet për të luajtur rolin e arbitrit dhe për të marrë vendime proaktive³⁴

³⁴Zobov, Aleksander; Degtereva, A Ekaterina; Chernova, Yu Veronica; Starostin, S Vasily Comparative Analysis of the Best Practices in the Economic Policy of Import Substitution

Hipoteza 3

4.8 Efekti Financiar dhe ekonomik i zëvendësimit të miellit dhe grurit nga importi me prodhim vendor

4.8.1 Efekti financiar dhe ekonomik i zëvendësimit të miellit nga importi me prodhim vendor

Sipas të dhënave nga Dogana e Kosovës, në Kosovë çdo vit importohen mesatarisht 20-30 milion kg miell në vlerë prej 5-9 milionë €.

Në bazë të dhënave nga (M&Silloso), fitimi neto nga shitja e 1 ton miell T-400 në Kosovë, është rreth 19 €/ton.

Fitimi neto i nga shitja e 1 ton miell tip 500 është diku rreth 15 €/ton, ndërsa fitimi neto nga shitja e 1 ton miell Special është 32 €/ton.

Nga sasia e përgjithshme e miellit të importuar në Kosovë, vlerësohet se rreth 60% e miellrave të importuar i përkasin miellit tip 500, rreth 30% i përkasin miellit tip 400 si dhe pjesa tjetër ose 10% nga totali i miellrave të importuar i përkasin miellit Tip special.

Supozohet se nga totali i miellit të importuar, në sasi prej 25 milionë kg në vit, Kosova do të arrin të bëjë zëvendësimin e tij në masë prej 10%, atëherë efekti financiar do të dukej kështu:

Fitimi i prodhuesve të miellit pas shitjes në treg, pra nga sasia e zëvendësuar e cila do të ishte 2.500 ton miell nga të cilat përfaqësohet (60%) ose

(60%) ose 1,500 ton miell tip 500 x 15 €/ton = 22,500 €

(30 %) ose 750 ton miell tip 400 me fitim 19 €/ton = 14,250 €

(10 %) ose 250 ton miell special me fitim 32 €/ ton = 8,000 €

Pra, përfitimi i përgjithshëm nga prodhuesit vendor të miellit në rast të zëvendësimit të importit të miellit me prodhim vendor në masë prej 10% nga totali i importuar do të ishte 44,750 €.

Shuma e parasë e cila do të shpërndahej për punëtorët të cilët janë pjesë e fabrikave të miellit do të ishte plus 17,000 €

Përfitimi nga distributori i energjisë elektrike KEDS për procesin e prodhimit do të ishte në vlerë 12,500 €.

Tabela 16. Efektet e zëvendësimit të miellit nga importi me prodhim vendor

Shkalla e zëvendësimit te importit të miellit*1	Sasia e zëvendësimit miellit të importuar (25,000ton - përqindja e zëvendësuar	Vlera e përfituar nga Pronarët e mullirit(sasia në ton x fitimi 15 €/ton për miell tip 400*a	Vlera e përfituar nga Pronarët e mullirit(sasia në ton x fitimi 19 €/ton për miell tip 500*b	Vlera e përfituar nga Pronarët e mullirit(sasia në ton x fitimi 32 €/ton për miell special*c	Vlera e përfituar nga punëtorët 9 € / 1.4 ton miell	Vlera e përfituar nga KEDS shpenzimi i rrymës 7 € / 1.4 ton miell	Totali i përfitimit në €
10%	2,500	22,500	14,200	8,000	17,000	12,500	74,200
20%	5,000	45,000	28,500	16,000	34,000	25,000	148,500
30%	7,500	67,500	42,750	24,000	48,2000	37,500	234,600
50%	12,500	112,500	71,250	40,000	80,400	62,500	366,650

- Shkalla e zëvendësimit është zbritur nga totali i importit vjetor të miellit (25 milionë kg ose 25,000 ton)
- *a nga totali i miellit të importuar, 60% është miell tip 500
- *b nga totali i miellit të importuar, 30% është miell tip 400
- *c nga totali i miellit të importuar, 10% është miell tip special

Në bazë të kalkulimeve të bëra mund të konkludojmë se:

Nëse zëvendësimi i miellit nga importi bëhet në shkallë prej 20% me prodhim vendor atëherë:

Pronarët e mullinjëve nga rritja e shitjes së miellit në shkallë prej 20% do të përfitojnë 89,500 €;

Pagat e punëtorëve do të rriten në vlerë prej 34,000 € ;

KEDS nga shitja e rrymës elektrike për procesin e përpunimit të miellit do të përfiton 25,000 €;

Përfitimi nga pronarët e mullirit, pagat e punëtorëve dhe përfitimi i KEDS do të rritet në proporcion të drejtë me shkallën e zvogëlimit të sasisë së importit, përkatësisht me rritjen e prodhimit vendor.

Nëse arrihet të zëvendësohet importi i miellit në shkallë prej 50% dhe ky import të plotësohet me prodhim vendor, atëherë përfitimet e prodhuesve dhe akterëve pjesëmarrës do të jenë:

Pronarët e mullinjëve nga shitja shtesë e miellit do të kenë përfitime në vlerë prej: 223,750 € në vit;

Pagat e punëtorëve pjesëmarrës në proces do të rriten për 80,400 €;

KEDS nga shitja e energjisë elektrike do të përfiton rreth 62,500 €;

Që në total, industria e Kosovës, në rast të zvogëlimit të importit të miellit në shkallë prej 50% nga totali i importuar do të përfiton rreth 366,500 € fitim neto në vit;

4.8.2 Efekti financiar dhe ekonomik i zëvendësimit të grurit nga importi me prodhim vendor

Për të elaboruar se cilat do të ishin përfitimet e shtetit të Kosovës, posaçërisht bujkut vendor si dhe prodhuesve të miellit në Kosovë (pronarëve të mullirit) atëherë duhet të paraqesim koston, përkatësisht fitimin nga kultivimi i 1 ha me grurë, për të përcaktuar efektin financiar se sa do të përfitonte në radhë të parë fermeri.

Në vijim do të paraqesim se sa do të përfitonte përpunuesi i grurit (pronari i mullirit).

4.8.3 Efekti financiar dhe ekonomik i zëvendësimit të grurit nga import me prodhim vendor

Në bazë të përlllogaritjeve më lartë mund të konkludohet se Kosova nuk i përmbush plotësisht nevojat e saja vjetore për konsum me grurë, andaj pjesën tjetër të grurit të nevojshëm e siguron nga importi.

Për secilin produkt të importuar, paraja kalon nga një vend tek vendi tjetër dhe me këtë rast vendi importues varfërohet

Sipas të dhënave nga (Dogana e Kosovës 2015-2020) sasia mesatare vjetore e grurit të importuar në Kosovë vlerësohet të jetë rreth 107 mijë ton në vit, që në vlerë arrin $107,000,000 \text{ kg grurë} \times 0.18 \text{ €} = 19,260,000 \text{ €}$ në vit.

Pra, çdo vit Kosova mesatarisht shpenzon rreth 20 milionë € vetëm për importin e grurit.

Sipas të dhënave nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MPBZHR), fitimi nga kultivimi 1 ha me grurë në Kosovë, në vitin 2018 ishte 38 € për ha, me rendiment mesatar 4500 kg/ha;

Në rast të zëvendësimit të importit të grurit, efekti financiar dhe ekonomik i bujku Kosovar do të ishte kështu:

Supozohet se, në rast se importi i grurit në vend do të zvogëlohej në shkallë 10% nga totali i importit, pra nga 107 mijë ton, importi do të zvogëlohet për 10% apo në sasi 10.7 mijë ton, me çmim mesatar 0.18 € /kg atëherë, vlera që do të përfitonin kultivuesit e grurit në Kosovë vetëm nga rritja e sasisë do të do të ishte 1,926,000 € .

Gjithashtu, nga subvencionet nga Qeveria e Kosovës, bujku do të përfitonte edhe 150 € shtesë për 1 ha grurë, pra 10,7 mijë ton grur me rendiment mesatar 4500 ton/ha përfshin sipërfaqe prej $2377 \text{ ha} \times 150 \text{ €} = 356,700 \text{ €}$.

Shuma e përgjithshme përfitimit nga kultivimi i grurit plus subvencionet do të ishte 2,282,700 €.

Nëse importi i grurit do të zvogëlohej në shkallë prej 20% nga totali i importit, pra nga 107 mijë ton, importi do te zvogëlohet për 20% apo në sasi 21.4 mijë ton, me çmim mesatar 0.18 E/kg

atëherë përfitimi i kultivuesve të grurit në Kosovë do të ishte 3,852,000 € vetëm nga gruri, po ashtu, bujku do të përfitonte edhe nga subvencionet nga Qeveria e cila ndan nga 150 € subvencion për 1 ha grurë, pra 21.4 mijë tone grurë me rendiment mesatar 4500kg/ha përbën 4755 ha x 150 € = 713,300 €.

Përfitimi i përgjithshëm nga kultivimi i grurit, përkatësisht zëvendësimi i grurit nga importi me prodhim vendor në shkallë 20% plus subvencionet nga Qeveria do të ishte në vlerë të përgjithshme 4,565,333 €.

Tabela 17. Efekti ekonomik i zëvendësimit të grurit nga importi me prodhim vendor

Shkalla e zëvendësimit të importit të grurit*1	Sasia e zëvendësimit grurit të importuar (107,000ton - përqindja e zvogëluar	Vlera e përfituar nga fermeri(sasia në ton x 180 e/ton	Subvencionet nga qeveria x 150 E/ha	Totali i përfitimit
10%	10,700 ton	1,926,000	333,300	2,259,300
20%	21,400 ton	3,852,000	713,000	4,565,000
30%	32,100 ton	5,778,000	1,070,000	6,848,000
50%	53,500 ton	9,630,000	1,783,333	11,413,000

*Shkalla e zëvendësimit është marrë si bazë sasia mesatare vjetore e importit të grurit 107 mijë ton/ vit për periudhën 2014-2019




Figura 10: Përfitimet nga zëvendësimi i importi të grurit me prodhim vendor në shkallë nga 10% deri 50%

4.9 Procesimi i Grurit: Kultivimi deri në Korrje

Në Kosovë gruri kultivohet kyesisht në vjeshtë. Sasia e orëve të punës të nevojshme për mbjellje është 4 deri në 6 orë dhe kostoja e punës për lërimin, lasimin, mbjelljen e farës, plehërimin, spërkatjen dhe korrjen e grurit është afro 160-170 € për hektarë . Fara e nevojshme për një hektar është rreth 300 kilogramë dhe kostoja e farës për kilogram është 125-140 €. Plehurat e përdorura për hektar janë Pleh artificial NPK 350 kg/ha me vlerë 135 €, Pleh artificial NAG me vlerë 105 si dhe herbicidet ne vlerë totale rreth 120 €/ha. Të korrat e grurit duhet të ruhen nga ndryshqet dhe sëmundjet e tjera, për këtë qëllim përdoren pesticide.

Tabela më poshtë tregon punën, farën, plehurat, pesticidet dhe nevojat e tjera nga kultivimi i grurit farë deri në korrjen e tij.

4.9.1 Marzha bruto dhe të ardhurat neto për ha

Kalkulimi i kostos së prodhimit për drithëra 2018-2020

Sipërfaqja për 1 ha

Në vijim do të paraqesim kalkulimin e shpenzimeve fikse të cilat shpenzohen për përpunimin e grurit në Kosovë.

Tabela 18. Kalkulimi i kostos së prodhimit të grurit në Kosovë

Të ardhurat	Njësia	Sasia	Çmim për njësi	Vlera në E
Gruri	Kg/ha	4500	0.16	720
Kashta	Dujë/ha	120	1.10	132
Gjithsej të ardhura				852
Kosto variabile				
Fara	Kg/ha	300	0.46	138
NPK	Kg/ha	350	0.38	133
NAG	Kg/ha	350	0.30	105
Herbicide 1	l/ha	2	5.00	10
Herbicide 2	ml/ha	150	0.08	13
Thasë	Copë	90	0.15	13.5
Gjithsej inpute				411.50
Shpenzimet e makinerisë				
Lavrimi	l/diesel	20	1.10	22.00
Lesimi	l/diesel	10	1.10	11
Mbjellja	l/diesel	8	1.10	8.80

Plehërimi	l/diesel	8	1.10	8.80
Spërkatja	l/diesel	8	1.10	8.80
Korrja	l/diesel	1	100	100
Transporti në stallë	l/diesel	8	1.10	8.80
Mirëmbajtja	Paushall			75
Gjithsej shpenzime të makinerisë				243.20
Gjithsej kosto variable				654.70
Marzha bruto				197.30
Fuqia punëtore	p/d	1.0	15.00	15
Mbjellja	p/d	0.5	15.00	7.5
Plehërimi	p/d	0.75	15.00	11.25
Spërkatja	p/d	0.5	15.00	7.5
Transporti në depo	p/d	0.5	15.00	7.5
Gjithsej shpenzime të fuqisë punëtore				48.75
Marzha bruto para zhvlerësimit				148.55
Zhvlerësimi				111
Të ardhurat neto				37.49
Subvencione	E/ha1		150	150
Të ardhurat neto subvencione				187.49

Burimi: MPZHR – DAESB 2018

Në bazë të rezultateve të arritura nga kalkulimet për shpenzimet e kultivimit të 1 ha grurë në Kosovë, rezulton se totali i shpenzimeve fikse arrin vlerën 813 € për ha.

Marzha bruto nga shita e grurit dhe dujeve është rreth 852 € për ha, me çmim të grurit 0.16 €/kg.

Fitimi Neto = Fitimi Bruto – Shpenzimet = 852 € – 813 €.

Në bazë të kalkulimeve të bëra, fitimi nga kultivimi i 1 ha grurë në Kosovë me rendiment mesatar 4500 kg/ha grurë dhe 120 dujë me kashë është rreth 38 €/ha.

Rekomandimet

Si një ekonomi bujqësore, Kosova mbështetet shumë tek te korrat e saj. Gruri është kultura më e mbjellur në vend. Dhe gruri është drithi kryesor, i cili pas përpunimit në miell përdoret si ushqim për njerëzit

- Prodhimi i përgjithshëm i grurit në vend duhet të rritet, sepse kjo është njëra ndër mënyrat më të mira dhe më profitabile për vendin për të ulur deficitin tregtar të drithërave të vendit si dhe për të ndaluar ose zvogëluar importet e grurit sa më shumë që të jetë e mundur.

- Shteti duhet të bëjë përllogaritje të sakta për sasinë e nevojshme vjetore të grurit, e cila përdoret për konsum apo ushqim për kafshë. Viteve të fundit, kemi tëpricë të grurit nga importi, pra, sasia e grurit që importohet është me e madhe sesa kërkohet. Në shumicën e rasteve, cilësia e grurit të importuar është më e mirë se cilësia e grurit vendas, si dhe problemi tjetër është dhe vlerësimi më i madh për grurin e importuar i përdoruesve dhe përpunuesve të grurit në Kosovë.

-Qeveria e Kosovës duhet të bëjë monitorimin e duhur në kufijë, duke mundësuar përcaktimin e sasisë adekuate me furnizim të grurit.

-Ky monitorim nga shteti së pari do të përcaktojë sasinë reale të nevojshme për import gjithashtu do të ndalojë hyrjen e paligjshme të grurit në vend

-Hyrja e paligjshme e grurit nga importi në vend, është problem i madh për përpunuesit vendor dhe kultivuesit e grurit, sepse ndikon drejtpërdrejtë në çmimin shitës të grurit, duke pamundësuar konkurrencën lojale në treg.

-Me përfshirjen e qeverisë së Kosovës në procedurën e importit të grurit dhe prodhimit vendor do të mund të zgjidhte disa probleme të importuara. Për shembull:

1. Qeveria duhet të sigurojë që fermerët të jenë të pajisur me farëra të përshtatshme dhe me cilësi më të mirë të saj.

2. Qeveria duhet të stimulojë prodhuesit e farës në Kosovë, duke siguruar farë gruri cilësore, me rendiment më të larte

3. Qeveria duhet të sigurojë që gruri farë dhe plehrat e importuara të testohen siç duhet përpara se të sigurohen fermerë dhe kjo gjithashtu me çmime të ulta.
4. Qeveria duhet të ketë negociata të duhura me prodhuesit vendor të grurit, përpunuesit vendor të grurit në mënyrë që të rritet taksat për miellin e importuar dhe taksa për grurin e importuar. Kjo do të ndikojë që prodhuesit të rrisin sipërfaqet e mbjellura me grurë si dhe mullinjtë të përdorin më shumë grurë vendas.
5. Politikat qeveritare duhet të sigurojnë lehtësim për fermerët dhe industrinë e grurit dhe miellit në tërësi duke i dhënë rëndësi kësaj industrie.
6. Hyrja e lëndës së parë në vend duhet të monitorohet, dhe lënda e parë duhet të sigurohet në kohë.
7. Qeveria duhet të rrisë vlerën e subvencioneve, nga 150 €/ ha në 250 € për/ha.
8. Mendoj se qeveria duhet të ndryshojë metodën e subvencionimit të grurit. Besoj së do të ishte më efikase subvencionimi i grurit në sasi të grurit të prodhuar, gjë që do të shtynte fermerët në përdorimin e farës së grurit më cilësore dhe me rendiment më të lartë.
9. Qeveria duhet të ndalojë hyrjen e grurit dhe miellit në vend që shitet me çmim dumping.

Konkluzionet

Qëllimi i këtij punimi është vlerësimi i gjendjes mbi tregun e miellit dhe grurit në Kosovë gjatë periudhës ndërmjet viteve 2014-2020, duke shqyrtuar prodhimin e grurit në vend, çmimin e grurit vendor dhe atij të importit, konsumin vjetor të miellit, problemet, mundësitë dhe rekomandimet se si të përmirësohet produktiviteti si dhe të trajtojë fluksin e importit masiv të miellit dhe grurit. Pavarësisht se politikat e shtetit mundohen që përmes granteve dhe subvencioneve të rrisin prodhimin e përgjithshëm të grurit në vend, akoma prodhimi vendor nuk po arrin të përmbushë kërkesat vjetore për grurë. Gruri në Kosovë kultivohet në 1 sezon, vetëm vjeshtë. Gruri është kultura më e kultivuar nga kultura e drithërave, i cili kultivohet në sipërfaqe mesatare vjetore rreth 80-90 mijë hektarë çdo vit me prodhim total vendor rreth 300 mijë ton. Megjithatë, kërkesa është më shumë se 400 mijë ton. Mungesa shpesh zgjidhet përmes importit të grurit nga vendet eksportuese si; Rusia, Serbia, Hungaria dhe Austria. Problemi me grurin vendor është se cilësia e grurit të prodhuar në vend është e dobët, prandaj njëri nga faktorët kryesorë të këtij importi është cilësia e grurit vendor. Grurit të prodhuar në vend i mungon cilësia që sigurohet nga gruri i importuar nga vendet e tjera. Në Kosovë duhet të krijohen laboratore të cilat do të mundësojnë modifikimin gjenetik dhe në këtë mënyrë mund të prodhohet grurë me cilësi më të mirë si dhe sasi (rendiment) më të lartë brenda vendit. Importet e grurit dhe miellit duhet të rregullohen në mënyrë që të kemi një plan të duhur se si të zëvendësohet importi i miellit dhe grurit dhe më këtë rast të rritet prodhimi në vend.

Përparimi në konsolidimin dhe mbrojtjen e tokës bujqësore i bërë deri më tani është i pamjaftueshëm. Nevojitet të ketë një qasje më strategjike në krijimin e një plani të qartë veprimi, duke u përfshirë: Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe autoritetet lokale, për të adresuar humbjen e qëndrueshme dhe degradimin e tokës bujqësore.

Për sa i përket masave mbrojtëse, mbështetësit e tregtisë së lirë argumentojnë se masat antidamping, ato kundërbalancuese, dhe ato mbrojtëse duhet të jenë alternativa e fundit për qeveritë, dhe se metoda të tjera të dialogut dhe bashkëpunimit duhet të shfrytëzohen fillimisht. Për shembull, në rastin e CEFTA-s, Kosova ka ngritur çështje të ndryshme (p.sh. barriera

jotarifore) në Sekretariatit e CEFTA-s, ku edhe shumica janë zgjedhur me dialog pa pasur nevojë për të shfrytëzuar masat e reciprocitetit. Disa nga sfidat kryesore në tregtinë e lirë që janë hasur në Kosovë janë sqaruar më poshtë:

Barrierat jotarifore të hasura nga kompanitë eksportuese veçanërisht me vendet anëtare të marrëveshjes CEFTA është një problem që vazhdon të paraqitet që kur Kosova është bërë pjesë e marrëveshjes. Disa nga barrierat më të shpeshta jotarifore që paraqiten janë:

- Pamundësia e përdorimit të territorit të Serbisë si tranzit për produkte të caktuara me destinim në vende tjera;
- Kërkesat e tepërta teknike për eksportimin e produkteve të caktuara në Shqipëri;
- Kërkesat e tepërta për dokumentacion;
- Verifikime të shumta të produkteve nga agjenci të ndryshme etj.³⁵

Gjatë elaborimit të hulumtimit kemi hasur në shumë problematika, ku përmirësimi i tyre do të kishte shumë efekte positive.

Problemi i parë është rendimenti i ulët i grurit për ha, më vetëm 3.68 ton/ha, gjë që fermeri vendas përfiton vetëm 38 € nga 1 ha me grurë duke mos llogaritur subvencionet nga qeveria. Rritja e rendimentit për 10% do të rriste të ardhurat për 10%.

Problemi tjetër është teknologjia e vjetër e përdorur dhe jo efikase, kombanjat e vjetëra gjatë korrjes sjellin humbje të rendimentit, si dhe zgjatjen e kohës së nevojshme për korrje.

Vlerëohet se në Kosovë cdo vit importohen 107 milion kg grurë, dhe supozohet se Kosova do arrin të zëvendësojë grurin nga importi me grurë vendor në masë 10%, atëherë do të përfitonte 1.9 milion €, pra kultivuesit vendor do të përfitonin nga shitja shtesë prej 10% rreth 1.9 milion €.

³⁵ <https://www.amchamksv.org/wp-content/uploads/2020/05/Analiz%C3%AB-Tematike-Tregtia.pdf> (parë për herë të fundit 05.02.2021)

Nëse Kosova do të arrinte të zëvendësonte importin e grurit me prodhim vendor në shkallë 50%, atëherë do të përfitonte rreth 11.4 milionë € në vit.

Në anën tjetër, tek prodhimi i miellit, Kosova ka potencial për prodhimin e miellit, prandaj nëse do të krijohen kushtet, që mielli nga importi të zëvendësohet me miell vendor atëherë sipas llogaritjeve, zëvendësimi i miellit të importuar me prodhim vendor në shkallë 10% do, të sjellë përfitim tek prodhuesit vendor në vlerë prej 74,000 €, dhe me rritjen e shkallës së zëvendësimit, do të rritet vlera e fitimit.

Në rast të zëvendësimit të miellit në shkallë 50%, fitimi te prodhuesit vendas do të arrinte vlerën prej 337,000 €.

Dhe në fund, sa i përket aspektit të lidhjes ndërmjet kualitetit dhe çmimit, në bazë të studimeve të bëra mund të arrijmë një konkluzion se: në vendin tonë, cilësia e miellit është përcaktuesi kryesor i çmimit, por krahas cilësisë është dhe sasia e kërkesës për miellin e tipit të caktuar, që nënkupton së sa është sasia vjetore e shitjes së miellit në raport me totalin e miellrave të shitur.

Pra cilësia e miellit të caktuar përcakton çmimin e tij.

Sektorët strategjik në Kosovë

Mes sektorëve strategjik që paraqesin potencial për rritje të eksportit janë përpunimi i ushqimit dhe produkteve bujqësore, ndërtimtaria, dhe industria e përpunimit të drurit. Këta sektorë të identifikuar në publikime të ndryshme janë identifikuar duke u bazuar në burimet që Kosova ka dhe duke u bazuar në industrinë që kanë pasur një performancë më premtuese të eksportit gjatë viteve të kaluara.

Bujqësia dhe përpunimi i ushqimit. Ky sektor luan rol të rëndësishëm në ekonominë kosovare, duke pasur parasysh që më shumë se 50% e popullatës jeton në zona rurale. Sipas një studimit të publikuar nga UNDP, pjesëmarrja e këtij sektori në Bruto Produktin Vendor është rreth 15%, si dhe ka potencialin më të lartë për punësim. Përkundër faktit që deficiti tregtar gjatë viteve të fundit është rritur në sektorin bujqësor, duhet të potencohet që edhe eksportet kanë shënuar rritje. Për momentin 80% e eksporteve të Kosovës në këtë sektor janë për vendet anëtare të CEFTA, përderisa vetëm 40% e importeve vijnë nga këto shtete. Shqipëria është vendi i vetëm me të cilin

Kosova kë balanc pozitiv tregtar sa i përket produkteve bujqësore, pra ku eksportet janë më të mëdha se importet. Bilanci më negativ tregtar në këtë sektor është me Serbinë dhe Maqedoninë. Për shkak konkurrueshmërisë së vogël, Kosova nuk ka arritur të shfrytëzojë plotësisht përfitimet që dalin nga tregtia e lirë në sektorin bujqësor, dhe vërehet që sektori ka nevojë për politika që do të rrisnin konkurrueshmërinë e industrisë me shtetet fqinje.³⁶

³⁶ <https://www.amchamksv.org/wp-content/uploads/2020/05/Analiz%C3%AB-Tematike-Tregtia.pdf>
(parë për here të fundit me datë 06.02.2021)

REFERENCAT/BIBLIOGRAFIA

- ¹Agjencia e Statistikave të Kosovës, (ASK), 2019, (parë për herë të fundit 26.01.2021)
- ² Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) – regjistrimi i fermave bujqësore në Kosovë (12.13.15.16.17) (parë për herë të fundit (26.01.2021)
- ³Agjencia e Statistikave të Kosovës, (ASK), 2019, (parë për herë të fundit 26.01.2021)
- ⁴Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) – regjistrimi i fermave bujqësore në Kosovë (12.13.15.16.17) (parë për herë të fundit 26.01.2021)
- ⁵Smith, Adam.“An Inquiry into the Nature and Causes of the Wealth of Nations” (1776)
- ⁶Rikardo“Principles of Political Economy and Taxation” (1817)
- ⁷Soana JAUPLLARI (TEKA) TREGTIA E JASHTME DHE ZHVILLIMI EKONOMIK NË NDIKIMIN E PROÇESEVE LIBERALIZUESE:RASTI I SHQIPËRISË fq. 4-6
- ⁸Douglas A. Irwin. THE RISE AND FALL OF IMPORT SUBSTITUTION working Paper 27919 <http://www.nber.org/papers/w27919> NATIONAL BUREAU OF ECONOMIC RESEARCH 1050 Massachusetts Avenue Cambridge, MA 02138 October 2020 (parë për herë të fundit 10.02.2021)
- ⁹Prebisch, Raúl. International Cooperation in a Latin American Development Policy. New York: United Nations (1954).
- ¹⁰Prebisch, Raúl. International Cooperation in a Latin American Development Policy. New York: United Nations. (1954).
- ¹¹Myrdal, Gunnar. Economic Theory and Under-Developed Regions. London: Duckworth (1957)
- ¹²Myrdal, Gunnar. An International Economy. Neë York: Harper & Bros(1956)
- ¹³Nurkse, Ragnar. Problems of Capital Formation in Underdeveloped Countries. Oxford: Basil Blackwell. (1953).

¹⁴Lewis, W. Arthur. *Aspects of Industrialization* (1953).

¹⁵Hirschman, Albert O. *The Political Economy of Import-Substituting Industrialization in Latin America* (1968).

¹⁶Love, Joseph. CEPAL, *Economic Development, and Inequality. History of Political Economy* 50, no. S1: 152–71 2018

¹⁷Myderizi, Arzana. Kosovo's comparative advantages: The agriculture sector, August 15, (2013)

¹⁸Myderizi, Arzana. Kosovo's comparative advantages: The agriculture sector, August 15, (2013)

¹⁹<https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-nees/statistikat-e-tregtise-se-jashtme-stj-dhjetor-2020-dhe-kalkulime-te-autorit>. (parë për herë të fundit 25.01.2021)

²⁰<https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/statistikat-e-tregtise-se-jashtme-stj-dhjetor-2020-dhe-kalkulime-te-autorit>. (parë për herë të fundit 25.01.2021)

²¹Raporti i Gjellbër i Kosovës, (2020)

https://www.mbpzhrks.net/repository/docs/Raporti_i_Gjelber_202003022021.pdf (parë për herë të fundit 18.01.2021)

²²Raporti i Gjellbër i Kosovës (2020)

https://www.mbpzhrks.net/repository/docs/Raporti_i_Gjelber_202003022021.pdf Dhe kalkulime të autorit

²³Raporti i Gjellbër i Kosovës (2020).

https://www.mbpzhrks.net/repository/docs/Raporti_i_Gjelber_202003022021.pdf dhe kalkulime të autorit.

²⁴<https://ask.rks-gov.net/media/5488/anketa-e-ekonomive-bujqesore-2019-2.pdf> – parë për herë të fundit me 02.02.2021.

²⁵Raporti i Gjellbër i Kosovës (2020).

²⁶Nikolic, Olivera; Jelic Miodrag; , Jovanovic Ljubinko , VARIABILITY OF SERBIAN WINTER WHEAT GENOTYPES AND THEIR EVALUATION IN TERMS OF SUSTAINABLE AGRICULTURE 2004).

https://www.researchgate.net/publication/262685011_VARIABILITY_OF_SERBIAN_WINTER_WHEAT_GENOTYPES_AND_THEIR_EVALUATION_IN_TERMS_OF_SUSTAINABLE_AGRICULTURE (parë për herë të fundit 25.01.2021).

²⁷(Muncan Petar, Todorovic Sasa, Muncan Mihajlo. Profitability of family farms directed at crop production(January, 2014).

²⁸STEENKAMP, Jan Benedict E.M. The relationship between price and quality in the marketplace, (1986).

²⁹<https://www.amchamksv.org/wp-content/uploads/2020/05/Analiz%C3%AB-Tematike-Tregtia.pdf> (parë për herë të fundit me 01.02.2021).

³⁰STEENKAMP, Jan Benedict E.M. The relationship between price and quality in the marketplace, (1986).

³¹Zobov, Aleksander; Degtereva, A Ekaterina; Chernova, Yu Veronica; Starostin, S Vasily Comparative Analysis of the Best Practices in the Economic Policy of Import Substitution.

³² <https://www.amchamksv.org/wp-content/uploads/2020/05/Analiz%C3%AB-Tematike-Tregtia.pdf>

(parë për herë të fundit me 01.02.2021)

³³ STEENKAMP, Jan Benedict E.M. The relationship between price and quality in the marketplace, (1986)

³⁴ Zobov, Aleksander; Degtereva, A Ekaterina; Chernova, Yu Veronica; Starostin, S Vasily Comparative Analysis of the Best Practices in the Economic Policy of Import Substitution

³⁵ <https://www.amchamksv.org/wp-content/uploads/2020/05/Analiz%C3%AB-Tematike-Tregtia.pdf> (parë për herë të fundit 05.02.2021)

³⁶ <https://www.amchamksv.org/wp-content/uploads/2020/05/Analiz%C3%AB-Tematike-Tregtia.pdf> (parë për herë të fundit me datë 06.02.2021)

Shtojcat

Lista e Anekseve

Aneksi 1. Parametrat minimale fiziko-kimike dhe reologjike për miellin Tip 400 sipas Standardit ndërkombëtar SK EN ISO/IEC 17025/2009

Tipi miellit	Tip-400			
Rezultatet e testimit me njësite e matjeve	Parametrat	Metoda	Kërkesat Meto	Rezultati
	Përmbajtja e lagështisë/Humidity conte	SSH ISO 712	Max. 15%	
	Përmbajtja e hirit / Ash content	S SH ISO 2171	0.45%	
	Përmbajtje e glutenit /Gluten content	SK EN ISO 21451-1	Min. 24 %	
	Përçindja e thartirës/Acidity percentage	S SH 1508-3	Max. 2.5%	
	Proteina	SK EN ISO 20483	Min. 9 %	
	Pasurimi me Hekur dhe ac. Folik		Min. 25mg/kg	
	FARINOGRAF			
	Aftësia e pirjes së ujit/Water absorpti.	S SH ISO 5530-1	Min. 55%	
	Zhvillimi/Development	S SH ISO 5530-1	1.4'	
	Stabiliteti / Stability	S SH ISO 5530-1	1.5'	
	Shkalla e zbutjes / Mitigation degree	S SH ISO 5530-1	Max. 80 Nj.F.	
	Numri kualitativ /Qualitative number	S SH ISO 5530-1	Min. 60	
	Grupi kualitativ / Qualitativ group	S SH ISO 5530-1	Min. B1	
	EKSTENZOGRAF			
	Energjia/ Energy	S SH ISO 5530-2	min. 80 cm2	
	Rezistenca 5 /Resistance 5	S SH ISO 5530-2	220Nj.E	
	Rezistenca Maksimale/Maximal Resistance	S SH ISO 5530-2	280 Nj.E	

	Shtirirja/ Extension	S SH ISO 5530-2	Min. 120 mm	
	Marrëdhënia /Relationship	S SH ISO 5530-2	1.5-2.5 R/Sh	
	AMILLOGRAF			
	Viskoziteti maksimal/ Maksimal viscosit	S SH ISO 7973-1	.400-900 Nj.A	
	Numri Rënës		250 – 350	
	W		Min. 160	
	Amidoni i demtuar		UCD MIN 15	
	Vetitë organoleptike		Era, shija, ngjyr	
Rregullativa ligjore	Standardi ndërkombëtar SK EN ISO/IEC 17025/2009			

Burimi: M&Silloi dhe kalkulime të autorit.

Aneksi. 2 Parametrat minimale fiziko-kimike dhe reologjike për miellin Tip Special sipas Standardit ndërkombëtar SK EN ISO/IEC 17025/2009

Tipi i miellit	Miell Tip Special			
Rezultatet e testimit me njësite e matjeve	Parametrat	Metoda standarde	Kërkesat e standardit	Rezultati
	Përmbajtja e lagështisë/Humidity content	SSH ISO 712	Max. 15.0 %	
	Përmbajtja e hirit / Ash content	S SH ISO 2171	Max. 0.55 %	
	Përmbajtje e glutenit /Gluten content	S K EN ISO 21415	Min.31 %	
	Përqindja e thartirës/Acidity percentage	S SH 1508-3	Max. 2.8%	
	Proteina	SK ISO 20483:12	Min. 12 %	

	Pasurimi me hekur dhe acid folik	S SH ISO 714	Min. 25mg/kg	
	FARINOGRAF			
	Aftësia e pirjes së ujit/Ēater absorption ability	S SH ISO 5530-1	Min. 55%	
	Zhvillimi/Development	S SH ISO 5530-1	Min. 1.5'	
	Stabiliteti / Stability	S SH ISO 5530-1	Min. 1.8'	
	Shkalla e zbutjes / Mitigation degree	S SH ISO 5530-1	Max. 50	
	Numri kualitativ / Qualitative number	S SH ISO 5530-1	Min. 100	
	Grupi kualitativ / Qualitativ group	S SH ISO 5530-1	Min. A2	
	EKSTENZOGRAF			
	Energjia/ Energy	S SH ISO 5530-2	min. 120 cm2	
	Rezistenca 5 /Resistance 5	S SH ISO 5530-2	Min. 300 Nj.E	
	Rezistenca Maksimale/Maximal Resistance	S SH ISO 5530-2	Min. 400 Nj.E	
	Shtirirja/ Extension	S SH ISO 5530-2	Min. 150 mm	
	Marrëdhënia /Relationship	S SH ISO 55302	R/Sh 1.5	
	Numri rënës-Falling number*		Min. 150	
	AMILOGRAF - Viskoziteti	S SH ISO 7973-1	Min. 200	
	ALWEOGRAF-W	SK ISO 20483:12	Min. 250	
	P/L*		Min. 0.30	
	Amidoni i demtuar-Starch demaget		23-28	
	Vetitë organoleptike		Era,,shija, ngjyra	
Regullativa ligjore	Standardit nderkombetar SK EN ISO/IEC 17025/2009			

Burimi: M&Sillosi dhe kalkulime të autorit

Aneksi 3. Parametrat minimale fiziko-kimike dhe reologjike për miellin Tip 500 sipas Standardit ndërkombëtar SK EN ISO/IEC 17025/2009

Tipi i miellit	Miell T-500			
Rezultatet e testimit me njësite e matjeve	Parametrat	Metoda	Kërkesat Met	Rezultati
	Përmbajtja e lagështisë/Humidity content	SSH ISO 712	Max. 15%	
	Përmbajtja e hirit / Ash content	S SH ISO 2171	Max. 0.55%	
	Përmbajtje e glutenit /Gluten content	SK EN ISO 21415	Min.23 %	
	Përçindja e thartirës/Acidity percentage	S SH 1508-3	Max. 2.8%	
	Proteina	SK ENISO 20483	Min. 9. %	
	Pasurimi me hekur dhe acid folik	S SH ISO 714	Min. 25mg/kg	
	FARINOGRAF			
	Aftësia e pirjes së ujit/Éater absorption ability	S SH ISO 5530-1	Min. 55%	
	Zhvillimi/Development	S SH ISO 5530-1	Min. 1.0'	
	Stabiliteti / Stability	S SH ISO 5530-1	Min. 1.5'	
	Shkalla e zbutjes / Mitigation degree	S SH ISO 5530-1	Max. 100	
	Numri kualitativ /Qualitative number	S SH ISO 5530-1	Min. 55	
	Grupi kualitativ / Qualitative group	S SH ISO 5530-1	Min. B2	
	EKSTENZOGRAF			
	Energjia/ Energy	S SH ISO 5530-2	min. 60 cm2	
	Rezistenca 5 /Resistance 5	S SH ISO 5530-2	250 Nj.E	
	Rezistenca Maksimale/Maximal Resistance	S SH ISO 5530-2	300 Nj.E	
	Shtrirja/ Extension	S SH ISO 5530-2	Min. 100 mm	
	Marrëdhënia /Relationship	S SH ISO 55302	1.8-3.5 R/Sh	

	AMILLOGRAF			
	Viskoziteti maksimal / Maksimal viscosity	S SH ISO 7973-1	350-700 Nj.A	
	Numri Rënës		200 – 300	
	Vetitë organoleptike		Era, shija, ngjyra	
Rregullativa ligjore	Standardit nderkombetar SK EN ISO/IEC 17025/2009			

Burimi: M&Sillosi dhe kalkulime të autorit

BIOGRAFIA E KANDIDATIT

Bsc. i diplomuar Veton Veliu u lind më 23 Shtator 1990 në Rahovec. Shkollën fillore e kreu në shkollën "Isa Boletini" në Rahovec, gjimnazin e vijoi në shkollën e mesme "Xhelal Hajdani" në Rahovec në drejtimin Shkencat Natyrore dhe e përfundoi me sukses të shkëlqyeshëm në vitin vitin 2008/09.

Në vitin 2009/10 V.Velieu regjistroi studimet bachelor në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë në Prishtinë dhe në vitin 2012/13 mori titullin Agronom i diplomuar.

Pas diplomimit në studimet bachelor, në vitin 2012/13 vazhdoi studimet post diplomike pranë Fakultetit të Bujqësisë në Prishtinë, në katedrën e Agroekonomisë përkatësisht në drejtimin Ekonomia e Bujqësisë dhe Ushqimit.